


BAJRAM RESULI

BIBLIOTEKA
SHTETIT

814-32

R 52

Pas kthimit nga lufta



Tregime

SH-32

R 57

BAJRAM RESULI

PAS KTHIMIT NGA LUFTA

Tregime e skica



2164

SHTËPIA BOTUESE «NALM FRASHËRI»

KODRA E TË GJASHTËVE

Armiku ishte vendosur prej disa ditësh në fortifikata të përgatitura më së miri. Vendi strategjik që kishte zgjedhur, një kodër nja 800 metra e lartë, ishte me të vërtetë i leverdisshëm për të. Prej andej, ai dominonte pothuaj një numër fshatrash përreth. Se si i kishin ngjitur në atë kodër disa topa, të cilët qëllonin vazhdimisht, askush nuk e dinte. Disa thoshin se kishin hapur një rrugë makine, disa të tjerë thoshin se i kishin ngjitur me disa mushka të mëdha. Topat qenë vendosur në majën e kodrës, e cila shtrihej në një gjatësi prej gati dy km. Vullnetarët, të cilët shikonin predhat që kalonin mbi kokat e tyre dhe që shpesh pëlçitnin fare pranë tyre, kërkonin që të sulmonin dhe ta zhduknin sa më parë atë fole të rrezikshme të armikut. Po komandantët e forcave kryengritëse kishin llogaritur se një sulm i drejtpërdrejtë mbi atë kodër, do të kërkonte viktima të shumta.

— Epo dasmë pa mish nuk bëhet, de! — tha një vullnetar trupgjatë, me gjoksin e zbuluar tërë lesh.

— Po nuk duhet të harxhohemi shumë, — tha një nga komandantët, — pa e dimë se s'ka dasmë pa mish!

— Unë mendoj se pa pasur topa nuk mund të sulmojmë, — tha i biri i Selim agajt, që edhe ai kishte ardhur «vullnetar» bashkë me fshatarët e tjerë. — Duhet rrahur njëherë mirë e mirë me topa dhe pastaj të bëjmë hyxhym, — vazhdoi ai.

— Po ku t'i gjejmë topat, or babaxhan?! — ia priti një vullnetar.

— Epo atëherë u pa kjo punë! Duhet të presim! Nuk dihet si e sjell punën allahu, — tha i biri i Selim agait. — Babai im thotë një fjalë: «mishi të piqet, e helli të mos digjet».

— Lërna ore, me gjithë atë babanë tënd, — tha një tjetër. — Po të jemi të zot, topat do t'ua marrim armiqve, siç ua morën të parët tanë denbabaden! — Atë çast një numër predhash fërshëlyen mbi kokat e vullnetarëve tanë dhe ranë sipër shtëpive të fshatit. Tymi u ngrit deri lart në qiell shtëllunga-shtëllunga të zeza.

— E shikoni se ç'bëjnë të poshtrit, or vëllezër, — tha njëri nga vullnetarët. — As që mendojnë se në ato shtëpi ka fëmijë, gra, pleq!

— Armiku nuk ka ardhur për të përkëdhelur fëmijët tanë, po për të na i vrarë, — tha kapedan Hazbiu, një burrë me shtat mesatar, pak thatim, me flokë të gjatë, me ballë të gjerë e me sy të zinj e të shndritshëm. — Ne jemi ata që do të mbrojmë fëmijët tanë. Atëherë, si thoni, vëllezër, — pyeti ai, — a do të rrimë akoma të bëjmë sehir armiqte që po na vrasin njerëzit tanë, po na shkatërrojnë vatrën tonë?...

— Të sulmojmë! Të sulmojmë! — buçiti zëri i vullnetarëve kryengritës. Pastaj komandantët e çetave u mbloodhën veç nga vullnetarët.

Mbrëmja e asaj nate të korrikut të vitit 1920 ishte plot zagushi. Vullnetarët kishin marrë urdhër të qëndronin në gatishmëri të plotë. Ata pritnin urdhrin e komandantëve të tyre për t'u hedhur në sulm kundër pozicioneve të pushtuesit. Herë pas here dëgjohej gjëmimi i topave të armikut, që qëllonin në drejtim të forcave tona, po predhat binin shumë larg, megjithëse fërshëllenin përmbi kokat e vullnetarëve. Italianët e kishin zakon që natën, nga frika, qëllonin herë pas here me top, në drejtim të pacaktuar, kuturu.

— Duhet njëzet vullnetarë, — tha kapedan Hazbiu. Vullnetarët me armë në duar përnjëherë u ngritën më këmbë dhe nxorën përpara gjokset e tyre, Kapedan Hazbiu zgjodhi njëzet prej tyre, nga më trimat. Ai i njihte mirë ata, se nuk ishte hera e parë që binin në luftë. Mbushën nga një torbë me bomba (bombat ia kishin kapur armikut tri ditë më parë në një sulm të befasishëm), nga një thikë të mprehtë në brez dhe pushkën krahëqafë.

— Ejani, vëllezër, pas meje! — tha kapedan Hazbiu. Dhe në errësirën e asaj nate korriku, ata u nisën me kapedan Hazbiun në krye. Po për çudi ata nuk u nisën drejt pozicioneve të armikut. Ata shkuan ndonjë orë larg nga vendi ku qenë, zbritën në një të tatëpjetë, pastaj hynë në një përrua të thellë, si hauz. Atje qëndruan pak. Kapedan Hazbiu u dha detyrën:

— Vështirë do ta kemi, vëllezër, po me çdo kusht duhet t'i ngjitemi këtij shkëmbi përpjetë. Rrugë tjetër nuk na ka mbetur!

— Do të ngjitemi pa tjetër, — pohuan njëzëri vullnetarët. Kështu, të njëzetët iu qepën atij shkëmbi lart i cili të çonte drejt e në pozicionet e topave të armikut. Duke qëndruar pak larg njëri-tjetrit, ata ngjiteshin ngadalë, me zor të madh. Opingat prej lëkure lope filluan t'i pengonin në ngjitje. Ata shpesh shkëmbin, prandaj i hoqën opingat dhe i vunë në torbë. Ash-tu, zbathur, ata filluan të ngjiteshin më lehtë, po këmbët filluan t'u rridhnin gjak prej gurëve që ishin të mprehtë si thika. Armiqtë lëshuan prozhektorët në drejtim të fushave e kodrave përkarshi, por atyre kurrë nuk mund t'u shkonte ndër mend se në atë shkëmb të thepisur, guva-guva, mund të ngjitej këmbë njeriu. Oficerët armiq e kishin studjuar mirë atë shkëmb dhe kishin arritur në përfundimin se prej andej nuk mund t'u vinte asnjë e keqe. — Këtej na mbron vetë natyra, — kishte thënë një nga oficerët më kompetentë.

Vullnetarëve këmbët po u pikonin gjak, trupi i tyre kullonte djersë. Po misioni ishte i rëndësishëm e duhej kryer me çdo kusht. Ata vazhdonin të ngjiteshin. Topat e armikut vazhdonin të qëllonin pozicionet e forcave kryengritëse. Të njëzetët i dëgjonin ato krisma tani fare afër. Dhe për çudi, ato krisma topash u jepnin atyre forca të reja, që të ngjiteshin sa më shpejt. Fryma po u merrej, zemra po u rekëtinte fort. Por ata edhe dhembjen e këmbëve që u pikonin gjak tanimë nuk po e ndienin.

Kishin mbërritur vetëm disa hapa larg topave të armikut. Rreth e rrotull asgjë nuk pipëtinte. Një qetësi e çuditshme edhe në pozicionet e armikut. Tani vullnetarët që nga poshtë i shikonin edhe grykat e topave që villnin flakë e zjarr. Ja, nga ato

gryka kishin dalë me dhjetëra predha, të cilat kishin bërë kërdrinë mbi shtëpitë e atyre fshatrave rreth e rrotull. Prandaj duhej zhdukur sa më parë ajo fole e rrezikshme, e cila sillte vetëm vdekje e shkatërrim.

Në orën 3.30 qetësia u prish. Kapedan Hazbiu me një zë të lartë, që të tmerronte, thirri: «O djema, përmbi topat!» — Dhe vullnetarët me një shkathtësi të habitshme u hodhën menjëherë mbi pozicionet e armiqve. Armiqtë, në llogoret e topave, të kapur në befasi, u ndodhën me të vërtetë në një gjendje tepër kritike. Nën breshërinë e bombave të dorës, të hedhura njera pas tjetrës nga vullnetarët, ata në fillim u gjendën të çorientuar. Klithmat e armiqve shoqëroheshin nga të shtënat e tyre, kuturu. Oh, ç'konfuzion i madh në radhët e armikut! Bile pati edhe vrasje padashur midis njëri-tjetrit. Një pjesë e tyre ngriheshin të alarmuar dhe, pa ditur se ç'po ndodhte, ia mbathën vrapit tatëpjetë korijes. Oficerët u thërritnin ushtarëve të qëndronin, të ktheheshin prapa, po shumë nga ata vraponin të alarmuar. Të njëzet luftëtarët tanë hidheshin sa nga njëri në tjetrin pozicion, qëllonin me bomba, me thika. Por edhe armiqtë sikur e morën veten. Ata filluan të qëllonin, të shanin, të thërritnin, dikush rënkonte me të madhe. Nga një kazermë pak më poshtë filluan të dilnin një numër i madh ushtarësh armiq, me një shpejtësi të rrufeshme, me karabinat nëpër duar. Oficerët e tyre, të alarmuar dhe me drithërima, thërritnin si të tërbuar: «Avanti ragaci sui briganti!» Dhe një breshëri shumë e dendur plumbash fërshëllente mbi kokat e luftëtarëve tanë. Ndërmjet flakëve që nxirrnin tytat e

1) — Përpara...

pushkëve të armikut, tanët i diktonin mirë ushtarët armiq. Të futur dhe të mbrojtur nëpër pozicionet e armiqve, mbrojtësit e të cilëve ata i zhdukën që në sulmin e parë, kryengritësit qëllonin mbi rreshtat e armiqve, që kërkonin të rimerrnin pozicionet e humbura. Tani filloi një përleshje shumë e ashpër. Italianët luftonin në mënyrë të dëshpruar. Po luftëtarët tanë i ndihmoi shumë si njohja e terrenit, ashtu edhe ardhja në ndihmë e shokëve të tyre, të cilët tanimë nuk pengoheshin as nga topat dhe as nga mitralozët e armikut. Dhe atëherë, oh, ç'përleshje u bë! Puna vajti deri në luftim trup me trup. Kamat futeshin në trup të armiqve, klithmat e italianëve ngriheshin deri në qiell. Tanët hidheshin si luanë mbi armiqtë, por edhe ata qenë u treguan trima. Dhe vetëm kur filloi të gdhihej dhe kur panë shokët e tyre të shtrirë e të rrokullisur sa andej-këtej, si mos më keq, mbytur në gjak, ata që kishin mbetur ngritën duart lart. Vetëm pak prej tyre mundën të iknin tatëpjetë asaj kodre. Nuk dihej me siguri sa vetë kishin qenë armiqtë, po dihet se prej tyre 31 vetë mbetën të vrarë, 40 të plagosur dhe 21 u zunë robër. Po ja, fytafyt me armiqtë në llogoret e tyre kishin rënë përgjithnjë edhe gjashtë bij të popullit tonë, bij të asaj krahine, dhjetë të tjerë të plagosur dhe një i humbur. (I humburi u gjend shumë ditë më vonë. Ishte i biri i Selim agait, i cili nga frika, kur çetat ishin hedhur në sulm, kishte bërë një kthim prapa dhe kishte ndalur vrapin te teza e tij, në një fshat të largët për të ngrënë petulla). I ati dhe e ëma e qanë për së gjalli djalin e tyre dhe pritën edhe ngushëllime. «Trimërisë dhe flijimit» të të

birit të Selim agait «një poet i kohës» i dedikoi një vjershë, ku ndër të tjera i thoshte:

«O Ridvan, o kapedan,
Re për popull e vatan,
Lum ai varr që ty të mban!»

Por «poetit» as që i shkoi ndër mend të thoshte qoftë edhe një fjalë të vetme për ata gjashtë luftëtarët e varfër që u flijuan fytafyt me pushuesit gjakatarë. Por Muminin, Hajdarin, Selmanin, Hydaiun, Musain, Muharremin, si të gjithë luftëtarët e lirisë, populli i përjetësoi në këngën e vet, duke e bërë veprën e tyre të pavdekshme. Që të gjithë ishin shumë të varfër dhe kurrë s'e patën ngopur barkun me bukë. Këmbët e tyre s'kishin veshur kurrë këpucë. Dhe ishte kjo arsyeja që autoritetet e asaj kohe nuk u kujtuan të zinin kurrë në gojë emrat e tyre, lërë më të vendosnin qoftë edhe një gur në vendin ku ata trima dhe heronj të popullit tonë derdhën gjakun për lirinë e atdheut. Ja për shëmbull xha Mumini, ai burrë i urtë e shakaxhi, me ato mustaqet e gjata deri te veshët, me atë këmishën tërë arna e këmbëzbathur, u gjend i vrrarë me thikën në dorë, ngulur thellë në gjoksin e një oficeri armik. Hajdari, ai djaloshi simpantik, që linte me gojë hapur njerëzit nëpër dasma me atë zërin e tij si bilbil dhe që fshatarët i thoshin «bilbili i fshatit», ishte ndarë tri copash nga një granatë e armikut. Ai sa kishte hyrë në të 25-at. Kishte trup të bukur, që ia kishin zili gjithë mo-

shatarët. Selmani, i hollë e i gjatë, me atë fytyrë të verdhë dyllë ngaqë vuante nga malarja, me një gomar të çalë, shiste dru në qytet për një copë babanace. Atij i thanë të mos vinte vullnetar, se ishte i dobët dhe i sëmurë, por ai ishte përgjigjur ashtu siç ia ndiente zemra: «Kur atdheu është në rrezik, njeriu harron veten e tij». — Dhe u gjend i shtrirë pranë shtratit të një topi armik e dukej sikur flinte. HYDAIU nuk kishte as një javë që ishte martuar. Punonte shërbëtor te një aga i Lubonjës, larg fshatit të tij. Agai shpirtkazmë e kishte lënë të rrinte me nusen vetëm tri ditë, se nuk pritnin punët e çiflikut. Po trimi MUSA? Ai kishte lënë në shtëpi gruan me dy fëmijë, nënën dhe babanë të paralizuar. Gruaja pas vrasjes së të shoqit ruante dhitë e fshatit për të ushqyer fëmijët dhe pleqtë që i la ai. Ja dhe MUHARREMI, ai djali me vetulla të trasha, që u gjend i vrarë mbi trupin e një oficeri madhor, me duart e tij të karfosura fort në fytin e armikut. Ai u rrit jetim, se babanë ia kishin vrarë turqit, kur kishte kundërshtuar pagimin e xhelepit. E kishte rritur e ëma me lakra të ziera. Edhe atë ditë, që u nis për në luftë, ai hëngri një sahan me lakra të ziera, me pak miell brenda...

Ata mbetën atje në atë kodër, në zemër të Labërisë. Mbetën si yje që ndriçojnë gjithmonë. Tani ai vend quhet Kodra e të Gjashtëve. Rreth e rrotull fshatarët kanë mbjellë qershi, në degët e të cilave çdo pranverë këndojnë bilbilat këngën e lirisë...

BRIGANTI¹⁾

Dielli i asaj dite të përvëlonte edhe në lartësinë prej 500 metra mbi nivelin e detit. Këtë nxehtësi e ndiente ndoshta më shumë nga të gjithë luftëtarë Mato Selami, i cili kishte më se gjashtë orë që udhëtonte me një shpejtësi të habitshme. Po cili ishte vallë ky Mato Selami? Ishte një djalë 24-vjeçar, me fytyrë të zeshkët, me vetulla të zeza, me trup të bëshëm dhe me duar të mëdha. Ishte rritur në varfëri të madhe. Ishte vëllai i vetëm i shtatë motrave. Prandaj iu desh që pa mbushur akoma të 10 vjeçët, të hynte bari te një aga i fshatit për të nxjerrë bukën e gojës, për të siguruar një copë bukë misri me dhallë. Vetëm pas dy vjetve agai i caktoi një rrogë të vogël, të cilën Mato Selami ia dorëzonte lek për lek babait. Kështu me bagëti, mal më mal e fushë më fushë, Matoja u rrit e u bë 24 vjeç djalë. E një ditë, kur në fshat u dha kushtrimi për të luftuar kundër armikut që kishte zaptuar vendin, ai e la kërrabën dhe mori pushkën.

Në atë ditë të korrikut të vitit 1920 udhëhe-

1) Komit, hajdut (kështu i quanin pushtuesit italianë, luftëtarët tanë të lirisë).

qësit e kryengritjes e ngarkuan Mato Selamin me një shërbim shumë të rëndësishëm: do të çonte një letër në Vlorë, te një person që vetëm ai e njihnte mirë. «Kjo letër, — i kishin thënë në shtabin e vullnetarëve, — nuk duhet të bjerë në asnjë mënyrë në dorën e armikut. Rënia e saj në dorën e armikut, — i kishin përsëritur ata disa herë, — mund t'i kushtojë luftës sonë me qindra të vrarë». — Dhe Matoja përpara shtabit kishte thënë: «Shpirtin mund të ma marrin, po letrën kurrë!». — Prandaj ecte Matoja me hapa të shpejtë dhe shikonte sa andej-këtej se mos dukeshin armiq gjëkund, në mënyrë që të evitonte takimin me ta.

Kur mbërriti afër Qafës së Koçitut përmbi qytetin e Vlorës, ai shikoi mirë rreth e përçark dhe, meqenëse nuk pa njeri, u ul nën hijen e një ulliri plak. Prej andej dukej gjithë qyteti i Vlorës. Në Vlorë ai kishte qenë vetëm një herë, kur kishte çuar disa bagëti për t'i shitur e për të blerë misër, kripë dhe sapun. Po tani Vlora kishte ndryshuar: nëpër rrugët e qytetit ai shikonte që prej andej shumë ushtarë armiq, që ecnin grumbuj-grumbuj, pastaj hynin e dilnin nëpër dyqanet e pakta që kishte qyteti. Ja dhe Skela, rruga e saj e mbushur plot me makina të armikut, zhurma e të cilave arrinte deri në veshët e Mato Selamit. Pastaj pak më larg Skelës dukej deti, i cili ishte mbushur plot me vapore, të mëdhenj e të vegjël, lufte.

«Pupu! — tha me vete Matoja. — Më shumë paska pamporë në det, sesa Vlora shtëpi». — Dhe mbasi hodhi sytë përsëri mbi shtëpitë e qytetit, murmuriti ngadalë:

«Vlorë, moj e bukur Vlorë,
Kërkojnë të të zaptojnë,
Po ti mos u tremb, moj zonjë,
Se ne kurrë s'të lëshojmë!»

Nga aty, ai dëgjonte herë pas here zhurmën e topave të armikut, që nga deti qëllonin në drejtim të fshatrave dhe të shokëve të tij. Pezmatohej dhe kthente sytë larg, andej nga pëlqitnin predhat. «Ndoshta, — mendonte ai me vete, — këto predha kanë rënë mbi shokët, kanë vrarë ndonjë prej tyre! Ptuh!» — pështynte ai në drejtim të armikut. Dhe ndërsa mendonte kështu, që prapa ai dëgjoi disa të thirrura të llahtarshme:

— Briganti! Briganti! — Matoja ktheu menjëherë kokën prapa dhe pa një grumbull ushtarësh armiq që kishin drejtuar tytat e pushkëve nga ai. U ngrit me një shpejtësi të rrufeshme dhe zuri vend në anën tjetër të trungut të ullirit. Por ja, armiq të tjerë i dolën dhe nga krahu tjetër. duke mbajtur edhe ata tytat e pushkëve në drejtim të tij. Dhe, ndërsa Matoja po mendohej se si mund t'i shpëtonte këtij rrethimi, në drejtim të tij, me gishtin në këmbëz të pushkës, u nis një rreshter mjekërzi.

— Dorëzohu, brigant! — thirri rreshteri. — Je refue!) — Matoja hodhi sytë nga rreshteri dhe pa se ai dridhej, megjithëse kishte pushkën në drejtim të tij, gati për të qëlluar. Rreshteri, kur u ndodh disa hapa para Matos, qëndroi dhe përsëriti me një zë hysterik e të llahtarshëm, që tregonte edhe mburrje, por edhe frikë:

1) Je i rrethuar.

— Duart lart! Je refue! — Matoja, që, si një rrufe u lëshua drejt rreshterit, i kapi armën nga dora dhe i ra me qytën e saj në kokë, me sa fuqi pati. Rreshteri lëshoi një britmë të tmerrshme dhe ra si një shakull me gjizë mu përpara tij. Gjaku filloi t'i rridhte shatërvan nga hundët e goja, sikur të qe therur një ka. Të tjerët, kur panë rreshterin të shtrirë për vdekje në tokë, u shtrinë barkas dhe filluan të qëllonin kuturu e të bërtitnin në mënyrë të llahtarshme. Matoja filloi të qëllonte me pushkën e armikut, po fishekët iu mbaruan shpejt. Duke menduar se mund të vritej nga çasti në çast, ai nxori me shpejtësi të rrufeshme letrën nga xhepi, e futi menjëherë në gojë dhe e kapërceu në stomak. Armiqtë e panë këtë veprim të tij dhe, kur e kuptuan se atij i ishin mbaruar fishekët, një grumbull sish iu hodhën nga prapa, e mbërthyen fort nga krahët dhe duke thirrur e bërtitur, i lidhën duart fort. Matoja ndodhej tani rob në duart e armikut. Ai këtë gjë as e kishte shkuar ndonjëherë ndër mend. Kishte menduar sa herë se mund të vritej, po që të binte në duart e armikut i gjallë, këtë s'e kishte shkuar kurrë ndër mend. Po ja që lufta paska edhe të papritura. Ai shikonte i habitur se si armiqtë u mblodhën mbi kufomën e rreshterit dhe qanin për shokun e tyre. Pastaj i drejtoheshin Matos duke i treguar pushkën dhe duke iu kërcënuar. Matoja qëndronte serioz dhe i shikonte të gjithë me rradhë. Pastaj një kapter e disa ushtarë e morën Maton duke bërtitur dhe duke sharë në gjuhën e vet dhe duke kaluar nëpër një rrugë plot shtigje e dredha e çuan në një trinçe¹⁾ prej betonarmeje,

1) Fortifikatë e nëndheshme.

e cila ishte në thellësi të një gryke, nën Qafën e Kociut. Brenda në të ishte një zyrë e vërtetë. Matoja hodhi sytë nga tavolina, ku ishte ulur një oficer armik të cilit i shndritnin në sup gradat e majorit. Ku ta dinte Matoja se tani ai ndodhej ballë për ballë me majorin Xhusepe Ferrari, i cili ishte kundërshtar i rreptë i tërheqjes së trupave italiane nga Shqipëria. Majori ishte nga Forlio Riçione, nga vendlindja e Musolinit. Bile e njihnte personalisht këtë të fundit dhe bënte pjesë edhe në partinë e tij. Kishte punuar në organet e shërbimit të fshehtë italian (në sektorin për Shqipërinë) qysh kur ishte 21 vjeç djalë. Dhe tani, kur ai kishte mbushur plot 31 vjeç, ishte një kuadër me rëndësi i shërbimit të fshehtë italian në Shqipëri. Ai mbante lidhje direkt me kryekomandantin e forcave ushtarake italiane në Shqipëri, gjeneral Sestimio Piaçentini. Vetë gjenerali e nderonte dhe e respektonte këtë major «fisnik dhe të zgjuar». Majori e çmonte shumë punën e spiunazhit. «Një informatë e rëndësishme për armikun vlen sa për një divizion me ushtarë. — thoshte ai, — kurse një letër e kapur në duart e armikut mund të na japë çelësin e fitores». — Dhe ishte pikërisht ky major shpirtkazzmë, që vullnetarëve shqiptarë u kishte vënë epitetin «brigant». Edhe gjeneral Piaçentini i kishte besuar shumë këtij majori zemërzi, kur kishte deklaruar «Shqipërinë e kam tabako për ta hequr në hundë. Ata pak brigantë të paarmatosur dhe të leckosur që janë, brenda një jave, në mos më shpejt, do t'i zë të gjallë si minjtë». — Ja, pra, me kë kishte të bënte tani Mato Selami ynë. Dy ushtarë e mbanin fort për krahësh Maton, megjithëse e kishin lidhur me zinzhirë.

— Brigant? — pyeti majori.

— Si, sinjor! — u përgjigj kapteri, që rrinte përpara Matos dhe ushtarëve që mbanin atë.

— Ku e zutë? — pyeti majori, duke e vësh-truar Maton nga këmbët deri te koka.

— Duke marrë informata rreth pozicioneve to-na, — gënjeu kapteri.

— Shiko, shiko, — tha majori. — Duket se edhe brigantët e kanë kuptuar rëndësinë e zbuli-mit, — vazhdoi ai pa i hequr sytë nga Matoja.

— Na vrau rreshter Ninon, — tha kapteri, duke ulur kokën dhe duke fshirë lotët.

— Si? Vrau rreshter Ninon? Nino Bastianin?!

— Si, sinjor, — tha kapteri me zë të ulët.

— O zot i madh! Rreshter Ninoja u vra! Nga ky brigant? — Majori shtrëngoi dhëmbët dhe iu drejtua Matos:

— Na paske vrarë rreshter Ninon, or brigant! Po më në fund re në dorën tonë! Dhe kështu, ja kështu do të bini të gjithë në dorën tonë! Ushtria jonë është e madhe, brigant! Ushtria jonë nuk mbarohet me vrasjen e rreshter Ninos, brigant! Ju nuk mund ta hani dot me ne. Ne jemi shtet dyzetmilio-nësh brigant! Kot e keni që luftoni.

Matoja u habit sa mirë e fliste shqipen ky italian. Ai hodhi sytë mbi të e po merrte frymë nga-dalë. Majori bëri një hap prapa.

— O santa Maria, sa nuk po më ha me ata sytë si të ujkut, — tha majori. Pastaj vuri duart prapa dhe iu drejtua Matos: — Na vrave rreshter Ninon, ë? Fol, fol! Pse nuk flet, mor brigant i ndyrë!

— Përse erdhët në vendin tonë, o italian? — tha Matoja serioz. — Shkoni në vendin tuaj, po të

doni të mos lini koskat këtu në Shqipëri, si rreshter Ninoja.

— Aha, — tha majori. — Ashtu, ë? — Dhe e qëllloi Maton me pëllëmbë në të dyja faqet, me sa fuqi kishte. Gjaku i buçiti Matos nga hundët, duke i mbuluar buzët, mjekrën dhe i binte mbi kraharon. Bëri ta fshinte, po duart i kishte të lidhura. Balli iu mbush tërë djersë të ftohta. Majori e shikoi i kënaqur Maton. Ky ishte dëfrimi më i madh për të. Iu duk sikur në këtë çast kishte qëlluar gjithë vullnetarët shqiptarë, që ai i quante brigantë!

— E, brigant? Jo vetëm me predha, por edhe kështu ju përshëndetim ne.

Matoja e shikoi drejt në sy majorin. Majori iu drejtua përsëri Matos:


— E mësove sa mirë përshëndetim ne?

— E mësova, zoti major, por edhe ne shqiptarët nuk përshëndetim keq. — Dhe me tërë forcën ngriti këmbën e djathtë dhe ia përplasi majorit në stomak. Majori, që nuk e priste një gjë të tillë, nga forca e këmbës së Matos ra menjëherë mbi tavolinë, duke rrëzuar përtokë takëmin e bojës si dhe një shishe me konjak. Ushtarët që ishin aty u trëmbsën, pastaj shtrënguan fort krahët e Matos dhe e shanë në gjuhën e tyre, ndërsa kapteri, mbasi ndihmoi majorin të ngrihej, nxori revolverin ta qëllonte Maton, po majori e ndaloi.

— Mos! — i tha ai kapterit. — Na duhet ky brigant! — Pastaj u drejtua nga Matoja: — Na vrave rreshter Ninon, brigant? Mua pate guximin të më qëllosh? — vazhdoi majori, duke u dridhur nga inati.

— Unë të ktheva përshëndetjen sipas zakonit tonë, — tha Matoja.

2164



— Ashtu, ë? Ashtu, ore ndyrësirë?! — ulëriti majori i tërbuar nga inati. Ai shpesh çonte dorën të barku, çka tregonte se ndiente dhembje. Pastaj vetë majori urdhëroi që Matos t'i lidhnin edhe këmbët, sepse, sipas tij, «briganti ishte i çmendur dhe mund të bënte gjithçka pa vetëdije». Ushtarët çuan menjëherë në vend urdhrin e majorit, duke e lidhur Maton me disa zinxhirë të trashë. Majori u ul në tavolinë i zverdhur në fytyrë. Sa shpejt ajo fytyrë «aq e hijshme» e majorit mori një pamje prej shtaze të egër.

— E kontrolluat? — pyeti majori.

— Si, sinjor, — u përgjigj kapteri.

— Çfarë i gjetët?

— Një copë bukë misri, një gjysmë qepe dhe pak gjizë. Një letër që kishte e gëlltiti në stomak...

— O perëndi e madhe! — thirri majori dhe iu drejtua kapterit: — Më flet për bukën e misrit, për qepën dhe për gjizën e më lë për në fund letërën! Po a e di ti, more hajvan, se ajo letër mund të ketë qenë çelësi i fitores sonë? — Kapteri rrinte drejtqëndrim, ushtarët mbanin për krahu Maton, kurse Matoja nuk i hiqte sytë nga majori.

— Është e vërtetë se e hëngre letrën, o brigant? — iu drejtua majori Matos. Matoja, sikur të mos i qe bërë asnjë pyetje, nuk i hoqi sytë nga majori.

— Përse hesht, ore brigant? Përse nuk përgjigjesh?

— E hëngri, — tha kapteri. — E pamë me sytë tanë.

— Ç'përbante ajo letër? — pyeti majori.

— Unë nuk di të shkruaj, — tha Matoja.

— Po kush ta dha atë letër? Këtë sigurisht që duhet ta dish!

— Ma dhanë në shtab, — tha Matoja.

— Hë, fillove të tregosh, ë? Atëherë na thuaj se ku do ta çoje! — pyeti majori, që kujtoi se tani Matoja do të tregonte gjithçka. — Hë, pra, na thuaj se ku do ta çoje!

— Do ta çoja në Vlorë, — tha Matoja.

— Në Vlorë, ë! Ah sa e doni atë të shkretë Vlorë! Po hiqeni mendjen andej. Vlora është e jona, o brigant, e jona! Ne jemi dhe do të qëndrojmë në Vlorë! Do të qëndrojmë përgjithmonë! Ja kështu!

Matoja me fytyrë e gjoks tërë gjak i hodhi sytë drejt fytyrës së majorit dhe duke nxjerrë gjoksin përpara, tha me zë të fortë:

«Italian, o lumëmadh,
Vlora nuk është livadh
Të hash ti, o breshkamadh!»

— Uaaa! Na qenke dhe poet, pa le! Hahaha!
Vetë i ke bërë këto bejte mor brigant?

— Populli! I këndon populli, zoti major! Ja edhe këtë e këndon populli:

«Italian o derëzi,
Vlora nuk është tagji,
ta përtypsh ti, breshkaxhi!»

— Mjaft, mjaft! — ulëriti majori. — Nuk dua të dëgjoj më të tilla gjëra! Mjaft! Më thuaj, te kush do të çoje letrën në Vlorë? E kupton mirë pyetjen, o brigant?

— E kuptoj shumë mirë, — tha Matoja.

— Atëherë përgjigju shpejt! — tha majori.

— Më keni lidhur fort, — tha Matoja.

— Gjuhën nuk ta kemi lidhur, de! — tha majori. — Ti ke liri të plotë të flasësh!

— Doemos, — tha Matoja. — Për të na dhënë «lirinë» keni ardhur që nga Italia këtu! Keni bërë sakrificë të madhe! — vazhdoi Matoja. — Prandaj edhe ne po ju presim me donoma!

— Dëgjo brigant! — ulëriti majori. — Me mua nuk ka guxuar të tallet njeri deri sot dhe guxoka të tallet surrati yt! Prandaj, më trego atë që kërkohet unë: ku do ta çoje letrën? Si të na thuash këtë, atëherë shko në shtëpinë tënde, se të presin njerëzit. Do të të japim edhe një palë këpucë me qafa, se paske mbetur zbathur, more fatzi! Hë, fol!

— Si thatë, zoti major? — pyeti Matoja.

— Oh, me ç'budallenj kam të bëj! — tha majori dhe u ngrit nga tavolina e iu afrua Matos. — Më thuaj; te kush do ta çoje letrën?

— Çudi! — tha Matoja. — Sa mirë që e ditkeni shqipen!

— E njoh mirë gjuhën shqipe, — tha majori. — gjuhën e brigantëve, — theksoi ai duke shtrënguar dhëmbët.

— Veç shqiptarët nuk i njokeni mirë, — i tha Matoja.

— I njoh me dhëmbë e dhëmballë! — tha majori me zë të vrazhdë.

— Po atëherë ç'dreqin ke që kërkon të të ja-

pin sekretet e tyre? Po t'i kishe njohur mirë shqip-tarët, do ta dije se ata nuk ia japin sekretin armi-kut! Të paktën, mësoje tani, zoti major!

— Egërsirë! — thirri majori si i xhindosur. — Ose do të tregosh, ose ta dish mirë: do të të var në litar, qen! — Pastaj majori iu drejtua kapterit: Nxirre përjashta brigantin, nxirre shpejt! Lidhni mirë me zinxhirë. Shpejt, shpejt! — ulëriti majori nga inati. Ushtarët e morën Maton për krahësh dhe e nxorën përjashta. Ngaqë këmbët i kishte të lidhura, Maton e tërhiqnin zvarrë. Ai dukej si një luan i lidhur, midis atyre njerëzve të shumtë, që e rrethonin atë nga të gjitha anët! Thërritnin ar-miqtë me zë të lartë, shamin dhe dikush e qëllonte edhe me shqelma. Po Matoja nuk ndiente gjë. Ai kishte rënë në mendime dhe as shikonte se ku po e çonin armiqtë. «O zot, o zot, — mendonte ai, — si nuk e kreuva dot shërbimin! Ç'do të thonë sho-kët, ç'do të thonë ata të shtabit për mua? Më be-soni, shokë, më dolën si miza e lisit, s'munda të shpetoj dot. Më zunë qafirët». — Këto mendonte Matoja, kur majori thirri me zë të lartë:

— Ej, brigant! A u mendove? A do të përgji-gjesh? — Matoja sikur u zgjua nga një gjumë i rëndë. Pa se e kishin çuar buzë një përroi dhe e kishin mbështetur pas trungut të një ulliri. Trupin ia kishin lidhur fort pas ullirit me ca zinxhirë të fortë e të trashë. Pastaj hodhi sytë rreth e rrotull dhe pa një numër të madh armiqsh të mbledhur rreth tij. Ata diçka thoshin në gjuhën e tyre, po Matoja nuk kuptonte.

— Fol, brigant! — bërtiti majori, që ishte ulur mbi një gur, në mes të ushtarëve të tij. Matoja e vinte re majorin që herë pas here çonte dorën në

barkun e tij dhe kafshonte buzën e poshtme. Tani u bind mirë Matoja se shqelmi i tij i rëndë, kishte bërë punën e vet mbi barkun e majmë të majorit kriminel! Majori, kur pa se Matoja nuk donte të fliste, urdhëroi me zë të lartë dhe të çjerrë:

— Ushtarë, nuk kemi kohë të presim! Jemi në luftë dhe çdo minutë na kushton shtrenjtë! Brigantin në litar, shpejt!

— Si, sinjor! — thirri kapteri.

— Atëherë zbatoni urdhrin! — ulëriti majori. Dhe menjëherë i bëri shenjë një rreshteri, i cili mbante një litar të gjatë në dorë. Ai iu afrua Matos, po për çudi po i dridheshin duart. Këtë e vuri re majori, i cili iu drejtua rreshterit:

— Serxhente!¹⁾ Mos vallë, të vjen keq për brigantin?

— Ç'është ajo fjalë, zoti major! Unë këta dua t'i ther për së gjalli, po nuk e di se si më vjen; ndoshta për rreshter Ninon, ju e dini që e kam pasur shok vogëlie dhe...

— Jemi në luftë, serxhente! — tha majori. — S'na kanë hije sentimentalizmat! Ja, qysh tani do t'ia marrim hakun rreshter Ninon! Vendose litarin! Shpejt! — Rreshteri hodhi litarin në degën e ullirit, pas të cilit kishin mbështetur Maton. Pastaj një grup ushtarësh e morën Maton dhe e vendosën më këmbë mbi një pllakë guri jo fort të trashë. Rreshteri i hodhi lakun e litarit Matos në grykë dhe shikoi në sy majorin. Majori u kthye nga Matoja:

— Tani, siç e shikon, litarin e ke në grykë! Mjafton të heqim pllakën që ke nën këmbë dhe

1) Rreshter, gradë ushtarake, nënoficer.

trupit tënd do të lëkundet në hava! Po neve na vjen keq, se je i ri dhe do të vdesësh kot! Pra, na trego se te kush do ta çojë letrën që hëngre dhe menjëherë do të ta heqim litarin. Edhe një herë të pyes, do të flasësh?

— Po, do të flas, — tha Matoja, me lakun e litarit në qafë.

«Hë, se ç'bën litari!» — mendoi me vete majori. — Ja, kështu edhe ti do të shpëtosh jetën, edhe neve do të na bësh një shërbim! — tha majori, duke iu drejtuar Matos me «dashamirësi». — Atëherë fol, se po të dëgjoj, — vazhdoi majori.

— Dëgjo. — tha Matoja me zë të lartë. — Në qoftë se ndonjëri nga ju nuk do të lërë koskat këtu, atëherë i kam rixha të tregojë se si vdiq «briganti» Mato Selami para litarit të armikut!

Majorit iu ngrit leshi i kokës përpjetë, filloi t'i dridhej gjithë trupi nga inati. Urdhëroi të hiqnin menjëherë pllakën e gurit mbi të cilën mbështeteshin këmbët e Matos dhe litari bëri punën e tij. Trupi i Matos qëndronte i varur në degën e ullirit, tre gisht mbi tokë, mbi atë tokë për të cilën ai dha jetën!

B U A L L I

Natën e 5 qershorit të vitit 1920, në mënyrë të befashme forcat vullnetare kryengritëse sulmuan armikun që ishte përqëndur në Kotë. Garnizoni armik në këtë vend kishte marrë masa të jashtëzakonshme për t'u siguruar nga çdo sulm i papritur. Rreth e rrotull ishin vënë tela me gjemba dhe pas telave vinte një mur i lartë prej gati tri metrash. Po kryengritësit e menduan mirë se si t'i kapërcenin ato pengesa të mëdha. Ata mbi telat vunë gunat e dhirta dhe bërrucat, kurse për të kaluar murin e lartë, hipën njëri përmbi tjetrin. Kështu mbas një lufte të ashpër, italianët, të gjendur në befasi nën plumbat, sëpatat, hanxharët dhe hunjtë e mëdhenj që mbanin vullnetarët nëpër duar, pësuan disfatën më të turpshme: ata që nuk u vranë, u dorëzuan.

Mbasi bënë «inventarin», e të vrarëve, të të plagosurve dhe të të dorëzuarve, komandanti i vullnetarëve thirri Agushin, një nga luftëtarët më të shpejtë e i tha:

— Agush! Shko shpejt dhe lajmëro skuadrën e Elmazit të kthehet sa më parë këtu!

— Si urdhëron! — u përgjigj Agushi dhe u bë veri. Pas disa minutave, ai u ndodh pranë skuadrës

së Elmazit. Ajo përbëhej nga dhjetë burra dhe ishte caktuar nga shtabi i vullnetarëve për të pritur ata armiq, të cilët mund t'i shpëtonin rrethimit. Mirëpo armiqtë nuk e panë të udhës që të bënin një copë rrugë, po mbetën aty ku ishin. Kjo bëri që skuadrës së Elmazit «nuk i takoi rasti të kacafytej me breshkamanët e përtejdetit», siç u shpreh me keqardhje njëri nga vullnetarët.

— Na e bëtë me hile, — i tha Elmazi, Agushit.

— Na nxuarët në fund të dasmës!

— S'kemi faj ne, — u përgjigj Agushi. — Fajin e kanë breshkamanët që nuk ju begenisin ju!

— Ptu! — pështyu një vullnetar. — Të presësh një natë të tërë dhe të mos të të vijë lepuri në shteg, kjo është e padurueshme!

— Mos u mërzit, o Bektash, mos, se do të kesh raste sa të duash! Ehu, sa t'i hedhim ata në det! Nuk ikin kollaj breshkamanët. U ka pëlqyer shumë vendi ynë! — tha Agushi.

— Epo edhe neve, — tha njëri nga vullnetarët, — po u japim vila të përjetshme, pa asnjë lek qira!

Pastaj të dhjetë vullnetarët e skuadrës së Elmazit, së bashku me Agushin, u nisën për në komandë. Rrugës Agushi u tregoi atyre se si ishte zhvilluar beteja, se si ai vetë ishte penguar disa herë mbi trupat e të vrarëve dhe të të plagosurve armiq!

— Veç na erdhi keq, — tha Agushi serioz. — se vramë edhe një buall!

— Heuk, buall?! — pyetën luftëtarët të habitur.

— E, ore, e, një buall! Dhe çfarë bualli, tërë mish e dhjamë!

— Dre! — tha njëri me habi. — Po buallin ç'e kanë dashur, a i vraftë zoti, i vraftë!

— Heuk! — ia priti një tjetër. — Po ti e di, ore Qani, se ata hanë edhe breshkat e bretkosat dhe jo buallin, që e hamë edhe ne!

— Po, xhanëm, po. — tha ai që kishte shfaqur habinë, — po nuk e dimë kujt ia kanë grabitur qafirët!

— Eshtë buall Italie, — foli Agushi, — Racë safi italiane! Dhjamë krejt!

— Shiko, shiko! — tha njëri. — Duket se e kanë prurë me pampor, jezitet!

— Domosdo me pampor! — u përgjigj tjetri, — pse, me ballon, a? — A thua do të na e pjekë komanda? — pyeti Elmazi.

— Besa, do shumë kripë, — tha Agushi. — Ne jemi pa thërrimen e kripës!

— Unë nuk ha mish bualli, sikur të bëhet qameti, — u shpreh një vullnetar me mustaqe të zeza, që i ishin varur nga të dyja anët deri në fund të mjekrës.

— E pse, nuk e ke ngrënë ti? Apo kujton se është si mishi i breshkës? — pyeti një tjetër.

— Nuk e ha, jahu, — u përgjigj burri me mustaqe të zeza.

— More po është tamam si mish kau, a derëzi! Vetëm është pak i fortë në të ngrënë, po me dhëmbët që ke ti përtyt edhe gurin dhe jo mishin e buallit!

— Ore, po pse, me zor do të më japësh mua mish bualli? S'e ha, ore vëlla, nuk e ha! Oj ky, ore!

— Në luftë hahet çdo gjë! Do të hash se s'bën!

— Mos vallë hahen edhe bretkosa e breshka? — foli i inatosur burri me mustaqet e zeza.

— Mos u zini, bre vëllezër, — tha Agushi, — se nuk ju jep njeri, mos keni merak! Buallin që

vramë do t'ua dorëzojmë italianëve, e kërkon komanda e tyre në Vlorë! Do t'ia dërgojmë peshqesh gjeneral Piaçentini!

Ndërkaq ata ishin afruar te vendi ku ishte zhvilluar beteja. Shikuan andej-këndej dhe sytë s'u zunë gjë tjetër veçse kufoma ushtarësh armiq, armë të djegura gjysma-gjysma, batanije, gëzhoja! Vullnetarët tanë i shikonin kufomat e armiqve me urrejtje, por edhe u vintë keq se si këto djem të rinj vinin e linin koskat këtu në kodrat e Shqipërisë!

— Po përse, ore të uruar, nuk rrini rehat në shtëpitë tuaja? Ptul! Jazëk, jazëk, goxha djem! Po pse na bini më qafë, ore të mallëkuar?! Rrini, or ju shoftë perëndia në vendin tuaj, ç'keni që na bini më qafë? — thoshte një vullnetar.

— Ua! — tha njëri i habitur. — Qenka vrrarë edhe Mikelinoja!

— E cili Mikelino, a i vrrarë?

— Ai që m'i binte më qafë sime motre. Barrijes, — tha njëri.

— Hë, mo, se ashtu ngjajnë ata njëri me tjetrin! Një biçim kanë të gjithë!

— Më plaçin sytë e ballit, ai vetë është! Ja, shikojani plagën në ballë nga guri që e qëlloi para një jave ime motër? E shikoni?

— Ua! Vërtet! — thanë të tjerët. Ushtari armik kishte rënë më kurriz, me fytyrë nga qielli dhe me krahët të shtrirë. Shumica prej tyre kishin rënë përmbys.

— Ja edhe bualli! — tha Agushi. — E shikoni çfarë bualli që është! Tërë dhjamë!

— E ku është dreqi? — pyetën vullnetarët.

— Nuk e shikoni?

Luftëtarët hodhën sytë andej-këndeje, por asgjekundi nuk po shikonin ndonjë buall.

— Nuk po shohim gjë, — foli Elmazi. — Ju të tjerët shikoni gjë? — pyeti ai.

— Jo! — u përgjigjën gati të gjithë në një gojë.

— Po ja tek është, ore vëllezër! — tha Agushi. Dhe shënoi me një shkop që mbante në dorë drejt një kufome të shëadoshë, që ishte shtrirë atje më tej gjatë-gjerë mbytur në gjak. Kishte një palë rroba që ndryshonin nga ato të kufomave të tjera. Në kapelë, e cila kishte rënë pak më tej kokës së tij dukej ylli i madh gjashtëcepash, rrethuar me shirita të artë.

— Gjeneral Goti! — tha Agushi. — A nuk ngjan si një buall i majmë?

Atëherë luftëtarët e kuptuan më në fund se ç'kishte ndër mend Agushi kur thoshte: «U vra një buall i majmë!»

NDODHI PAS NJË SULMI

Xha Aliun e njoha një ditë, në kafenenë e Pallatit të madh të Kulturës në Tiranë. Kisha dëgjuar edhe më parë për të, po nuk më kishte rënë rasti ta njihja nga afër. Më njohu Tajari, një nga veteranët e Luftës Nacionalçlirimtare.

— Ky është xha Aliu! — më tha Tajari. — Pjesëmarrës i dy luftërave: i Luftës së Vlorës (të vitit 1920) dhe i asaj Nacionalçlirimtare. U përqa-fuam me të sikur të njiheshim prej kohësh. Megjithëse mjaft i moshuar, ai mbahej mirë. Kisha qejf të dëgjoja nga goja e tij ndonjë ngjarje, sidomos nga Lufta e Vlorës, po nuk e di pse më vinte rëndë t'i thosha, ndoshta pse e njoha për herë të parë, apo ndoshta ngaqë mendoja se ai tani ishte mbi 75 vjeç dhe më dukej sikur do ta rëndoja. Ku ta dija unë se xha Aliu kishte dëshirë të tregonte ndodhira të Luftës së Vlorës dhe nga ato të Luftës Nacionalçlirimtare.

— E shikoni atë personin që është ulur atje tej, veç të tjerëve? — na u drejtua xha Aliu. Ne hodhëm sytë nga na tha ai. Pamë një burrë nja 50 vjeç, i dobët sa të thoshe se ku i qëndronte shpirti, me një palë rroba të ndotura, që ishte ulur në një cep të sallës dhe po pinte çaj.

— E njihni? — na pyeti xha Aliu.

— Jo, — i thamë ne. — Nuk e njohim. — Dhe

sytë nuk po i hiqnim nga personi për të cilin na pyeti xha Aliu.

— Është i biri i Azem beut, — na tha xha Aliu.

— As Azem beun nuk e njohim, — thashë unë.

— Ah, ç'farë e keqe janë këta! — psherëtiu plaku. — Do t'ju tregoj unë se ç'më ka ndodhur me të atin e atij kodoshi, që po pi çaj atje tej, me Azem beun! — tha plaku dhe vazhdoi: — Sulmin kundër arditëve ne e filluam aty nga ora tre e mëngjesit të shtatë korrikut të vitit 1920. Atë sulm e bëmë më tepër për të zënë të gjallë një farë kapiten Xhuzepe Fiorentini, i cili ishte bërë tmerr për krahinën tonë. Ç't'ju them më parë për të këqijat që na kishte bërë ai kriminel me fytyrë njeriu! Kishte vrarë para syve të nënës djalin e vetëm, Adilin, sepse ky kishte qëlluar dhe e kishte lënë të vdekur një ushtar italian që i kishte rënë më qafë së motrës. Kishte djegur disa shtëpi të fshatrave, kishte torturuar me dorën e tij shumë fshatarë dhe më në fund kishte mbyllur në xhaminë e fshatit disa pleq e plaka dhe i kishte vënë flakën. Dhe, sikur të mos kishte harruar një penxhere të xhamisë hapur, ata do të ishin djegur të gjallë. Mirëpo plani ynë nuk u realizua. Xhuzepen nuk e zumë dot as të gjallë dhe as të vdekur. Se si na iku, këtë nuk e morëm vesh. Na erdhi inat sa më s'bëhet. Vërtet vramë e zumë të gjallë shumë prej arditëve, por atë që deshëm ne nuk e zumë. S'lamë vend pa kontrolluar atyre dushqeve mos ishte fshehur gjëkund, po nuk e gjetëm.

— Epo s'kemi ç'bëjmë, — na tha komandanti.

— Ai duket ka ikur para sulmit. Po do ta zëmë; mos keni merak! — vazhdoi ai. Atë ditë, gati gjithë ditën, u morëm me të vrarët dhe me robërit.

Robërit i çuam në Vajzë, se ashtu ishte urdhri i komandës, kurse të vrarët i varrosëm poshtë një kodre. Në darkë u ndamë nëpër shtëpitë e fshatarëve. Mua me tetë shokë të tjerë na caktuan të shkonim për të fjetur dhe për të ngrënë në konakun e Azem beut, që ishte ndonjë orë larg prej vendit ku ne kishim sulmuar. Me të marrë urdhrin, u nisëm. Ishim pa gjumë dhe pa ngrënë. Nxituam të arrinim sa më shpejt. Mbërritëm aty nga ora tetë e mbrëmjes. Unë dhe tre shokë të tjerë, e mbaj mend si sot, kishim ca pushkë të gjata, kurse të tjerët, përveç pushkëve që i morën në sulmin e natës së kaluar nga armiqtë, kishin edhe hanxharë, sëpata, thika dhe hunj të mëdhenj. Zati me këto të fundit shumë fshatarë kishin sulmuar një natë më parë. E, megjithëse tani u pajisën me pushkë, nuk i lanë hanxharët, sëpatat, thikat dhe hunjtë, sepse, siç thoshin ata, ato i nxorën në selamet.

Konakët e Azem beut dukeshin që larg. Shtëpitë ishin dykatëshe: tri dhoma poshtë dhe tri lart. Si arritëm para portës, unë trokita fort. Nuk u ndie njeri. Pritëm mjaft. Pastaj trokita më fort se herën e parë. Pas pak doli qehajai i beut, një farë Dalip Vrenozi. I tmerrshëm ka qenë ai Dalip Vrenozi. Kusinë e vetme ua merrte nga zjarri bujqve, kur ata nuk kishin të paguanin për qiranë e tokës. Hoqi ngadalë llozin e portës dhe tha serioz:

— Kush është? Ç'kërkoni tani në mes të natës?

— Jemi vullnetarë! — i thashë unë. — Jemi caktuar nga komanda të hamë dhe të flemë sonte këtu!

— Sa vetë jeni? — pyeti ai.

— Tetë vetë.

— Të lajmëroj beun, — tha ai. — Pritni! —

I vuri llozin portës dhe hyri brenda. Pas disa minutash doli vetë Azem beu. Qehajai i rrinte prapa me fener në dorë. U hap porta dhe beu bëri një hap jashtë saj:

— Po ku jeni, mor shqiponjat e Azem beut!..

— Jemi shqiponjat e Shqipërisë, — i thashë unë.

— Po, tamam, të Shqipërisë, — tha Azem beu, të cilit nuk i pëlqeu ndërhyrja ime. Po na nderoni racën tonë, për allanë! Ju lumtë, se po lini nam! Po tregoheni me të vërtetë stërnipër të Skënderbeut dhe djem të vërtetë të Ismail Qemalit! More po qenkeni ezhdërha fare, për allanë! More, po ju lumtë! Po ju...

— Jemi caktuar të hamë dhe të flemë sonte këtej nga ju, — i thashë unë, kur pashë se beu nuk kishte ndër mend ta mbaronte «fjalimin» e tij.

— Posi, posi jo! — tha ai. — Mirë se të vini! E keni hallall për allanë! — Dhe u kthye nga qehajai: — «Dalip, çoi këta trimat në koçekët e misrit të flenë sonte dhe u thuaj shërbëtorëve t'u pregatitin për të ngrënë! Po shpejt, se janë lodhur, të varfërit, duan të mbledhin koskat!»

— Bej! — iu drejtova unë. — Ne jemi caktuar në konakët tuaj dhe jo në koçekët e misrit! Ne s'jemi kafshë, po jemi njerëz!

— Po nuk ka vend në konakët, more trim, — tha Azem beu. — Sikur nuk dua t'ju fut unë!

— Gjithë kjo shtëpi s'paska vend për tetë vetë?! — thashë unë. — Kjo s'na besohet!

— Po nuk ka, jahu, — tha beu. — Ja, në një odë po fle çupa, në tjetrën djali, në të tretën fle unë me gruan, një e kemi dhomë pritje, një odë gjumi për miqtë....

— Epo edhe ne sonte miq jemi, o bej, — thashë unë. Dhe hyra në oborr. Pas meje u futën edhe shokët e tjerë, me hanxharë, me sëpata e hunj nëpër duar. E pashë që beu u shqetësua shumë dhe diçka i tha qehajait ngadalë, duke bërë gjeste të shumta me duar. Dalipi na doli përpara dhe tha në mënyrë të prerë:

— Urdhri i beut...

— Urdhri i komandës është mbi urdhrin e beut, — i thashë unë. Dhe kisha bërë hesap që, sikur të më kundërshtonte me forcë, do t'ia ndaja dysh kokën atij Dalip Vrenozit, aty mu në mes të oborrit. Por ai ndoshta e kuptoi se ç'mund ta gjente, prandaj u tërhoq dhe shkoi përsëri afër beut. Diçka biseduan kokë më kokë njëri me tjetrin. Unë dëgjova që beu i tha Dalipit: «Miku të shkojë shpejt në qilar!» Unë nxitova hapat. Edhe beu nxitoi dhe më doli përpara.

— Të paktën hajdeni në këtë dhomën tjetër! — dhe më zuri për jake. Unë vura re se beu po dridhej i tëri. Sidomos fjalët e tij që i tha qehajait «miku të shkojë shpejt në qilar», ma shtuan dyshimin se diçka do të kishte në këtë mes.

— Andej do të vijmë — i thashë, — andej, po dale sa të nderz një cigare në këtë dhomën ku ka dritë, se m'u ça hunda. Dhe hyra. Hynë dhe shokët e tjerë pas meje. Po ç'më zunë sytë! Xhuzepen! Po, po, Xhuzepen! Kriminelin, vrasësin e djalit të vetëm para syve të nënës, djegësin e shtëpive tona e kishte strehuar Azem beu, i ati i atij kodoshit që po mendohet për gjemitë e fundosura në det. Ne e njohëm Xhuzepen porsa e pamë. Ai dridhej si ndonjë purtekë. Interessant! Nuk tentoi të qëllonte, por u ngrit më këmbë dhe mbahej fort pas

fustanit të zonjës së beut, e cila gjithashtu dridhej nga frika. Xhuzepja kishte veshur një palë rroba të beut që të mos njihej, kishte rruar mustaqet spic, po ne, siç ju thashë, e njohëm porsa e pamë.

— Paç faqen e zezë, or bej! — i thamë ne. — Bijtë e Shqipërisë po derdhin gjak, po japin jetën, kurse ti fsheh kriminelët! Turp, or bej, turp të kesh!

Azem beu uli kokën dhe s'dinte ç'të thoshte. Pas pak, ai tha ngadalë:

— Do ta sillja vetë në komandë!

— Jo more! — I thashë unë. — Po përse e ke veshur me rrobat e tua?

— Hë, bej, fol! — ia priti një nga luftëtarët, i cili i doli beut përpara me hanxharin e madh në dorë.

— I kishte grisur rrobat e tija, — tha gruaja pa u menduar. — Prandaj ia veshëm këto!

— I paski therur edhe pulë, e? — i thashë unë.

— Epo helbete, mik i largët! — qeshi një nga shokët tanë.

— E kishim për vete, — tha beu. — Ai na gjetë në bukë dhe i thamë të shtrohej të hante me ne. — Në tavolinë sa ishin shtruar tri pjata me mish pule dhe një shishe e madhe me raki.

— Nuk e vazhduam më muhabetin, — tha xha Aliu. — Për ne çdo gjë ishte e qartë. Nga gëzimi e lidhëm Xhuzepen mirë me litar dhe ashtu siç ishte, i veshur me rrobat e beut, e çuam në komandë.

Ja, — përfundoi tregimin e tij xha Aliu. — Kjo ishte historia e Azem beut. Kjo farë e keqe akoma nuk është zhdukur. — Dhe hodhi sytë nga ai burri koskë e lëkurë, që shikonte drejt nesh, sikur ta din-te se po tregohej historia e babait të tij.

NENA E MYSTEHAKUT

Kjo ndodhi ato ditë të nxehta gushti të vitit 1920, kur, i madh e i vogël në atë krahinë ishte përfshirë në atë luftë që bëhej për jetë a vdekje. Mijëra e mijëra bij të popullit, nga të katër anët e atdheut kishin rrëmbyer armët, hanxharët dhe sëpatat për të dëbuar zaptuesin që kishte pushtuar vendin. Dhe një nga këta mijëra ishte edhe djali i vetëm i nënë Hazbies, Mystehaku i saj i dashur. Nënë Hazbia e kishte rritur atë me një mijë mundime, jetim, pa babë, se babai i Mystehakut kishte mbetur diku, qysh në vitin 1900. Thanë se ai ishte vrarë në Jemen, por e vërteta ishte se atë e kishin vrarë vetë turqit kur kishin marrë vesh se kishte braktisur ushtrinë e tyre. Duket ai nuk e kishte duruar dot mallin për Atdheun e tij, për gruan, për djalin. Sipas dëshmitarëve ata e kishin kapur në një fshat afër Përmetit dhe e kishin pushkatuar në vend si «shkelës të ligjeve të zëvendësit të Allahut në tokë». Pastaj kishin hapur fjalë sikur ai ishte vrarë në Jemen. Me djalin pesë vjeç, nënë Hazbia kishte vendosur të mos martohej, po të qëndronte me të birin pesë vjeç, ta rriste atë dhe ta bënte burrë. Dhe djali u bë me të vërtetë azgan, me trup të gjatë, ezmer, me sy të zinj e me flokë të dendur. Po

ja, vendi u pushtua, filloi lufta kundër të huajit e djali doli vullnetar. Dhe vetëm dhjetë ditë pas shkuarjes së djalit, nënë Hazbies i erdhi një lajm i hidhur: djali ishte plagosur rëndë dhe ndodhej i shtruar në spitalin e Kotës. Në fillim ajo mbeti si e ngurosur, pastaj e mblodhi veten dhe po në ato çaste vendosi të shkonte menjëherë në Kotë, të shkonte djalin e saj të vetëm. Mystehakun e saj të dashur.

«Oh, bir, bir i nënës! A do të të gjejë nëna me shpirt!» — Dhe menjëherë bëri gati kalin, një kalë të kuq trupvogël, po që në të vërtetë ishte shumë i shpejtë, si shigjetë! Mori një torbë dhe as vetë nuk e di se ç'futi në të. I hipi kalit dhe u nis me të shpejtë. «Hë. Kuqo, më ç'o shpejt, ta gjej tim bir, Mystehakun me shpirt!» — thoshte ajo me zë të lartë. Dhe kali, sikur ta kuptonte se ç'i thoshte e zonja, ecte me një shpejtësi të habitshme. E s'kaloi shumë, kur qimet e kalit, vende-vende u mbytën në djersë, por ai nuk e ngadalësoi shpejtësinë. Dhe nënë Hazbia mbahej fort në kaptellin e samarit, sikur të ishte një kalorëse e stërvitur mirë. Në të vërtetë ajo ishte mësuar mirë në kalë, sepse mbas mobilizimit të të shoqit nizam dhe sidomos pas vdekjes së tij, ajo vetë u detyrua të shkonte në mulli për të bluar, në mal për dru, në qytet për pazar, te miqtë kur e ftonin nëpër dasma ose në rastet vdekjesh. Ajo ishte bërë, siç thoshin fshatarët, me të vërtetë burrë e kaluar burrit. E, ndërsa kalë ishte bërë erë drejt Kotës, nënë Hazbia mendonte se me sa mundime e kishte rritur atë djalë, ç'kishte hequr e ç'kishte vuajtur me të dhe se si kohët e fundit ajo i kishte thënë atij se do ta martonte dhe se si ai kishte ulur kokën në shenjë aprovimi.

Edhe për nusen ajo kishte menduar, po nuk ia kishte thënë të birit. Do t'ia thoshte porsa të kthehej nga lufta. Këto mendonte nënë Hazbia dhe psherëtimte thellë e fshinte lotët që i binin herë pas here.

«Hë, Kuqo, hë, ta gjej tim bir me shpirt!» —
Dhe Kuqoja bëhej erë.

Kur mbërriti pranë një burimi, ajo ndaloi kalin. Zbriti, e mori kafshën për kapistre dhe e çoi nën hijen e një peme të madhe. Kali ishte bërë qull në djersë. Nënë Hazbia i hodhi një rrobë të vjetër mbi vithet, për të mos u ftohur. Këtë zakon ajo e kishte mësuar nga i shoqi, që kur ishte nuse e re. Pastaj shkoi te burimi, hodhi disa grushta ujë në fytyrë dhe u ul mbi një gur. Kali filloi ta hante me uri atë çikë bar të thatë që ishte ndodhur rastësisht nën hijen e asaj peme. Nënë Hazbia u ngrit ngadalë, bëri disa hapa më tej, mblodhi ca bar të thatë dhe ia solli kalit. Kali fuste në gojë me shpejtësi të çuditshme gjithçka gjente përpara, bile edhe ferrat. Dukej se ai ishte tepër i uritur. Nënë Hazbia po priste që të çlodhej pak sa të hante dy gojë barë kali e të udhëtonte me të shpejtë që të arrinte sa më parë te djali. «Ha, Kuqo, ha, që të shkojmë shpejt!...»

Po në këtë çast ajo dëgjoi një si rënkim, që vinte nga diku aty afër. Nënë Hazbia ngriti kokën, dëgjoi atë rënkim të rëndë dhe heshti për disa sekonda. Po rënkimi sa vinte po shtohej e po dëgjohej më shumë.

«O zot i madh! — tha nënë Hazbia. — Më bëjnë veshët kështu, apo mos është vërtet rënkim?» — Dhe ngadalë bëri disa hapa më poshtë. Përsëri dëgjoi me kujdes, bile edhe frymë merrte ngadalë,

në mënyrë që të dëgjonte sa më mirë. Rënkimi tanimë sikur pushoi. Ajo prapë nuk u besonte veshëve.

«Mos vallë të rënkuarat e djalit vijnë deri këtu tek unë?! Nuk është e mundur! — mendoj ajo me vete. — Djali im nuk rënkon kurrë». Po për çudi, rënkimi filloi përsëri, bile ai u bë më i shpeshtë e me zë të llahtarshëm.

«O zot, o zot, — tha ajo, — ç'po ndodh kështu me mua?» — bëri përsëri disa hapa më tej. Këtë radhë ajo bashkë me rënkimin dëgjoi edhe disa fjalë të shkëputura, po nuk mori vesh asgjë. Instinktivisht këmbët e çuan drejt zërit, andej nga vinte rënkimi. Hodhi sytë përpara e për çudi, pranë trungut të një peme, pa një ushtar armik të mbledhur shuk, mbuluar tërë gjak, që po rënkonte e po thërriste në gjuhën e vet. Në fillim nënë Hazbia u tromaks, bëri të kthehej prapa, por italiani që e pa, thirri duke lebetitur e duke bërë shenja me dorë:

— Mama... mama!...

Nënë Hazbia qëndroi, i hodhi sytë mirë nga italiani, pastaj bëri disa hapa drejt tij.

— Mamaaa!...

— Ç'mama më ke ti mua, more qafir! Ti je dushman për mua! — Italiani filloi të dridhej dhe të qante. Lotët i binin çurkë nëpër faqet e verdha dyllë. Nëna shikoi rreth e rrotull se mos kishte të tjerë armiq, po nuk diktoi asnjë. Një pushkë më tej ushtarit të plagosur, një pagur, një batanije, një çantë. Më tej një kapelë e gjakosur, pastaj një këmbë e prerë dhe më tej akoma disa copa këmbë e duar njerëzish, të copëtuar si duket nga granatat. Një vazhdë gjaku dukej mbi bar... Ushtari armik tanimë nuk rënkonte, veç i kishte hedhur sytë në-

në Hazbies dhe lotët i binin çurkë, qante me dënesë. Nëna iu afrua fare pranë ushtarit armik:

— Eh, i mjeri ti, si qenke katandisur! — Italiani vazhdonte të qante me dënesë dhe zuri të thoshte diçka në gjuhën e vet, duke bërë gjeste pasgjestesh me duart e llangosura tërë gjak. Ai tregon-te me dorë plagët, gjakun, lutej e lutej për shpëtim. Të gjitha këto nënë Hazbia i kuptonte mirë. Dhe për një çast iu kujtua se si disa ditë më parë këta armiq kishin ardhur në fshatin e saj. Eh, si mburreshin e tundeshin atëherë! (Me festet e kuqe e me xhufkën blu në kokë, me kafkën e të vdekurit në gjoks dhe me thikë ndër dhëmbë!), ata u kërcënoheshin e u kallnin tmerrin fshatarëve). Kurse tani prej gjithë atyre mburrjeve e kërcënimeve, kanë mbetur gjaku, copëra të trupave të tyre...

— E, vetëm je, a, mos qofsh? — pyeti nënë Hazbia.

— Shokët lanë, — tha italiani me gjysmë zëri. — Unë rashë gropë, plagosa. Skipëtarët bump, natën, shokët vrap, mua lanë këtu!

— Oh, farë e keqe! — tha nënë Hazbia. — Asnjëri-tjetrin nuk e doni. — Pastaj vështroi italianin nga këmbët deri te koka. Ai ishte bërë dyllë i verdhë, kufomë e gjallë. — Mos ma ke plagosur ti djalin tim, o i mallëkuar? Apo mos je ti që vrave fëmijtë e Xhaferrit të... Apo mos je ti që i vure flakën fshatit?

Italiani nuk e kuptoi se çfarë thoshte nënë Hazbia. Ai dridhej e lutej si mos më keq. Nëna iu afrua,

1) Uniforma e arditëve. Arditët ishin kriminelë të nxjerrë nga burgjet, të cilët ishin të gatshëm të bënin lloj-lloj krimi.

po sa më tepër i afrohej aq më i shëmtuar dilte ai trup i gjakosur, ajo fytyrë meit. Miekra e tij e zezë, e parruar kushedi prej sa ditësh, tundej si ndonjë shtëllungë leshi. Flokët e gjatë i kishin rënë përmbi fytyrë dhe ia kishin zënë fare sytë. Nënë Hazbies i vajti mendja menjëherë tek i biri. «Edhe im bir, ndoshta kështu është bërë», — mendoi ajo. «Po të paktën ai lufton për vatanin e tij, kurse ky derr, vatanin e ka në Itali». Pastaj padashur, në mënyrë instinktive, i foli italianit me një zë të ashpër:

— Fol, o i mallëkuar, mos ma ke plagosur ti djalin?

— Unë mama...

— Mos më thuaj mama, hej dreq! Mamatë shqiptare nuk pjellin të tillë kriminelë si ju, që t'u bien më qafë të tjerëve, e mos t'i lënë rehat në shtëpi të vet!

— Unë Italia ka grua, dy pikoli...

— E, ore, e, marr vesh unë se ç'llomotit ti! — Pastaj e zuri nga krahu: — Çohu, pa çohu njëherë!

— Italiani bëri një sforco për t'u ngritur, po nuk mundi. Atij i ishin thyer të dyja këmbët. Nënë Hazbia e shikoi këtë radhë me keqardhje.

— Po nuk e dini ju, or lanetër, se Shqipëria është vakëf dhe kush e nget katandiset kështu si ti?

— Ujë... ujë... — thirri italiani. Nënë Hazbia mori pagurin që kishte rënë atje tej dhe e mbushi te burimi. Pastaj me dorën e saj i dha të pinte italianit. Ai pinte me etje të madhe. Si piu gjysmën e pagurit, nënë Hazbia ia hoqi nga goja. Italiani i zuri dorën nënë Hazbies duke iu lutur që t'i jepte akoma, po nënë Hazbia i tha:

— Të bën keq, he dreq! Më vonë të jap prapë.
— Italiani e shikoi me habi nënë Hazbien.

— Gracie, mama, — tha ai.

— S'marrka vesh ky i paudhë, — tha nënë Hazbia. — Akoma më thërret mama. — Pastaj iu drejtua atij me zë të fortë: — Nuk të kam djalë, dëgjon? Ti erdhe të më zaptosh shtëpinë, ti dogje fshatin, ti vrave fëmijtë e Xhaferrit, ti më plagose djalin! Prandaj mos më thuaj mama, se më vjen krupë, dëgjon! — Italiani rënkoj thellë. Pastaj nënë Hazbia e urdhëroi edhe një herë: — Pa mundohu të çohesh njëherë! — Ai bëri përsëri sforco për t'u ngritur, po përsëri nuk mundi. Ai i bëri shenjë nënë Hazbies se nuk mund të ngrihej. Nënë Hazbia i zgjati dorën. Ai u mbajt fort pas dorës së saj, por ajo nuk e mbajti dot tërë atë peshë dhe ai ra përtokë, duke i zënë koka pas një trungu të një ulliri plak.

— U vrave? — pyeti nënë Hazbia. Italiani rënkoj thellë.

— Hajde, se kështu i do mushka drutë, — tha ajo. Pastaj shkoi, mori kalin, e afroi pranë italianit. U ul më gjunjë dhe i bëri shenjë ushtarit armik të mbahej fort në supet e saj. Dhe kështu me zor e hipi në kalë. Italiani ra përmbys mbi samarin e kalit, po nuk mbahej dot. Nënë Hazbia hoqi litarin nga kaptelli i samarit dhe e lidhi italianin në mënyrë që të mos binte dhe të mos anonte nga asnjëra anë. Pastaj hodhi pushkën e italianit kraheqafë dhe u nis.

— Do të të çoj në spital! — tha ajo. — Vërtet do të më vonosh ca, por unë jam nënë e më vjen keq të të lë e të të hanë korbat. — Ajo ecte përpara me hapa të shpejtë, duke hequr kalin për kapistre. Armiku mbi samar të kalit, i lidhur me litar, rën-

konte herë pas here. Nënë Hazbia kthente kokën prapa, e shikonte italianin dhe i vinte keq për të, po kur mendonte se kishte ardhur nga anë e anës për të pushtuar trojet e të tjerëve, ajo inatosej dhe mbushej tërë urrejtje.

— Jalla u shofshi, o perëndi, që nuk na lini rehat! Një mos mbeçi, ishallah!

Mbas disa orësh udhëtimiti, nënë Hazbia me italianin në majë të kalit arriti në Kotë, ku ishte vendosur spitali i vullnetarëve. Përpara ndërtesës së spitalit ajo pa një grup vullnetarësh, disa prej të cilëve kishin lidhur kokën, disa të tjerë me paterica. Ata, kur panë italianin të lidhur mbi kalë, qeshën me të madhe.

— Mos qeshni, or bijtë e nënës, — tha ajo, — po më thoni, është gjallë Mystehaku? Mystehak Selimi ia thonë emrin...

— Po ti kush je? — pyeti një nga vullnetarët, që kishte lidhur kokën me një fasho të bardhë.

— Nëna e Mystehakut. Rron im bir?

— Mystehaku e kaloi rrezikun, — thanë gati në një gojë vullnetarët që ishin pranë. — Doktor Sezaiu ia hoqi plumbin që i kishte mbetur në kofshë. Tani ai është fare mirë. — Nënë Hazbies i pikuan lotë nga sytë. Ata ishin lotë gëzimi.

— Ai luftoi si luan, — thanë ata.

— Shpirti i nënës! — tha nënë Hazbia. — E dija se nuk do të më turpëronte!

— Po këtë, ç'e ke? — pyetën ata, duke i hedhur sytë nga italiani.

— E gjeta të plagosur, të mjerin! E kishin lënë shokët. Se si ka qenë puna, le t'ju tregojë vetë, se nëna nuk e di gjuhën e tij. Shërojeni që, kur të vejë në Itali, t'u tregojë shokëve se ç'hoqi në Shqi-

përi. Ndoshta nxënë mend të mallëkuarit e s'na
ngasin herë tjetër. — Pastaj kërkoi ta çonin te djali.
Dy nga vullnetarët e morën për krahu nënën dhe
e çuan tek i biri, ndërsa të tjerët zgjidhën italianin
nga samari i kalit dhe e çuan në një ndërtesë të
veçantë, ku ishin edhe shumë robë lufte, të plago-
sur rëndë dhe që mjekoheshin nga shqiptarët.

NUSKA E DERVISH ZENELIT!

Vullnetarët porsa ishin ulur nën hijen e një lisi të madh. Ishin nja 30 burra, të veshur të gjithë me rroba të vjetëruara. Midis tyre disa kishin mbetur fare zbathur, sepse opingat prej lëkure lope, që kishin pasur kur kishin hedhur armët në sup, u ishin bërë copë-copë nëpër gurët dhe shkurret e atyre kodrave, duke ndjekur këmba-këmbës armiqtë. Megjithatë ata e ndienin veten të gëzuar për fitoren që kishin korrur një natë më parë në një sulm kundër një garnizoni armik dhe prandaj ia kishin marrë këngës:

«Ja do bëhet Vlora jona,
Ja do vdesim gjith'sa jemi!
Djem, rrëmbeni gjithë armët,
Në rrezik vendin e kemi!

— Pushoni, vëllezër! — tha komandanti. Kënga pushoi menjëherë. Komandanti, një burrë nja dyzet vjeç, me mustaqe të verdha, të gjata deri te veshët, i parruar prej më shumë se dy javësh, vuri dylbitë në sy (ato ia kishte marrë një oficeri të lartë armik, me të cilin ishte ndeshur trup me trup) dhe pasi vështroi me kujdes, tha: — Një njeri me dy

kuaj doli në breg dhe po vjen drejt nesh. Kujdes!

— Do të jetë ndonjë hafije e breshkamanëve,
— foli njëri nga luftëtarët.

— Ta kapim të gjallë! — tha një tjetër.

— Mos u nxitoni, vëllezër! — tha komandanti.
— Mund të jetë ndonjë fshatar i këtyre anëve.

Ndërkaq, njeriu i hipur në kalë po afrohej drejt vullnetarëve. Dhe vetëm kur u ndodh nja 500 metra larg, komandanti hoqi dylbitë nga sytë dhe duke qeshur foli:

— Ptu! Kush qenka!

— Kush? Kush? — pyetën gati në një gojë vullnetarët.

— E dini kush? — tha komandanti. — Dervish Zeneli, ja kush na qenka!

— Bën nuska të forta ai, — tha një nga vullnetarët. — Thonë se ka plasur në vend lopën e Sheros, se i hëngri brekët që kishte nderë në degën e ulët të fikut. — Shumë nga vullnetarët qeshën, ndërsa njëri prej tyre tha serioz:

— Eshtë e vërtetë, për allanë! Edhe unë kështu kam dëgjuar!

— Pallavra! — tha komandanti, një djalë i zgjuar dhe trim nga një fshat i rrethit të Tepelenës. Pastaj ai dha disa fakte mbi mashtrimet që bënte dervishi në popullsinë e fshatrave përreth.

Ndërkaq dervish Zeneli po afrohej te luftëtarët. Ishte burrë nja 55 vjeç. Nuk kishte punuar kurrë. Gjithnjë ishte marrë me nuska, me mashtrimin e njerëzve. Çdo behar ai merrte dy kuajt dhe shkonte fshat më fshat, si i caktuar nga allahu për të «shëruar» të sëmurët, siç thoshte ai lart e poshtë. Dhe si ngarkonte kuajt me «hakun» që merrte për nuskat që u bënte fshatarëve, kthehej në shtëpi,

bënte disa ditë pushim dhe nisej përsëri, po këtë radhë në ato fshatra ku nuk kishte qenë beharin e kaluar. Punë me leverdi të madhe kishte gjetur dervish Zeneli!

Tanimë ai i ishte afruar shumë vendit ku po qëndronin luftëtarët. Kur i pa ata, ndaloi menjëherë kafshën dhe deshi të ndërronte rrugë, po komandanti, që e vuri re dredhinë e tij, i thirri:

— Hajde, o dervish, hajde na jep uratën dhe ti për luftën që po bëjmë! — Dervish Zenelit iu drodh i gjithë trupi. «Do të më marrin «hakun», — tha ai me vete. E humbi toruan fare. Kali ikte sipas dëshirës së tij. (Kalin tjetër e kishte lidhur pas samarit të kalit të parë, në të cilin kishte hipur vetë). Kur arriti pranë luftëtarëve, ai e mblodhi veten dhe pa zbritur nga kali tha me zë të frikshëm:

— U ndiftë allahu, o burra!

— Na ndiftë pushka, o dervish, — tha komandanti, — po ulu, ulu pak nga kali!

— Vallahi, jam larg, o zotëri!

— Aaa! Do ta dredhim nga një cigare, — tha komandanti dhe zuri me dorën e tij të madhe, tërë kallo, frerin e kalit. Dervish Zeneli, kundër dëshirës së vet, zbriti ngadalë. Kali u lehtësua nga gjithë ajo barrë e rëndë. (Dervishi kishte hipur në mes të dy thasëve me miell gruri, të situr me sitën e bakllavasë. Të tillë miell pranonte dervishi, që nuskat të zinin më mirë).

— Po si je, more dervish? — pyeti komandanti.

— Ejvallah, mirë, zoti komandant!

— A ke marrë vesh se po luftojmë me Italinë, që na ka zaptuar vendin? — pyeti komandanti.

— Si nuk e kam marrë, ejvallah! — tha dervishi. — Këtë e ka marrë vesh e gjithë bota!

— Po ti me se merresh këto ditë?

— Unë? Po ja, ejvallah, unë merrem me këto punët e perëndisë!

— Thonë se bën nuska të forta!

— Mundohem t'i lutem allahut dhe ai, me të madh të tij, më dëgjon, — u përgjigj dervishi.

— Epo kur qenka kështu, kusur e ke të më bësh edhe mua një nuskë, — tha komandanti.

— Peqe, jahu! — pohoi dervishi. — Po përse e do zotrote nuskën?

— Që të mos më zërë plumbi, — tha komandanti.

— Po si jo, jahu, — u përgjigj dervishi. Unë mund t'ju bëja të gjithëve nga një nuskë që të mos ju zinte plumbi i armikut, po m'u mbarua ajo lanet kartë, se këtë radhë kam bërë shumë nuska nëpër fshatra. Kam gjetur shumë të sëmurë!

Dervish Zeneli nxori nga xhepi një copë letër, një laps kopjativ, e futi lapsin në gojë, e bëri me pështymë dhe filloi të shkaraviste në letër disa shkronja arabisht, duke muimuritur diçka me vete. Pastaj e palosi letrën në formë trekëndëshi, shkaraviste përsëri disa shkronja arabe mbi të, e puthi tri herë dhe pastaj ia zgjati komandantit:

— Merre dhe vëre në xhepin e majtë të palltos! Dhe me këtë nuskë mos ki frikë, se as topi nuk të zë! Dhe dëgjo këtu: e kam bërë në atë mënyrë që, kushdo që ta mbajë atë nuskë, të mos e zërë plumbi!

Komandanti e mori nuskën dhe po e mbante në dorë. Diçka po mendonte. Vullnetarët po shikonin me habi. Ç'do të bënte vallë, komandanti me atë nuskë? Do ta vinte vërtet? Shumë nga ata e dinin se komandanti kohët e fundit nuk u besonte

jo vetëm nuskave, por as allahut. Ai kishte shprehur disa herë dhe bile edhe pak më parë urretje për ata që bënë të tilla nuska, që mashtronin popullin. Po tani, ku vanë fjalët e tij? Kështu mendonin shumë nga luftëtarët. Ndërkaq ata ndiqnin me vëmendje çdo lëvizje dhe çdo gjest të komandantit të tyre.

— Ku duhet ta vë? — pyeti komandanti.

— Të thashë, biri im, — tha dervishi, — në xhepin e majtë të palltos!

— Mos u mërzit, ejvallah, — foli qetë komandanti, — se mua më ka bërë një çikë allahu të trashë nga mendja. Prandaj merre dhe vëre njëherë ti, që ta shoh se si duhet vënë!

— Kollaj, ore bir, kollaj, — tha dervishi. Ai ia mori nuskën nga dora komandantit dhe e vuri në xhepin e majtë të palltos së vet. — Ja kështu, bir, — tregoi dervishi më në fund. — Veç një gjë, mos vërë sende të tjera në atë xhep!

Ndërkaq komandanti bëri disa hapa prapa, hoqi pushkën nga supi dhe shënoi në drejtim të dervish Zenelit. Dervishi ngriti kokën dhe u tmerrua kur pa që gryka e pushkës ishte në drejtim të tij.

— O allah i madh, — u lut dervishi, — ç'po bën ashtu, or biri im?

— Asgjë, asgjë, — tha komandanti, — veç dua të bëj një provë nëse të zë plumbi apo jo me nuskën që ke në xhep!

— Mooos! Aman! Mooos! — thirri duke lebetitur dervishi.

— Mos ki frikë, jahu, — tha komandanti. — Ti vetë the se me atë nuskë nuk të zë as topi dhe jo më plumbi!

Komandanti i hoqi sigurecën pushkës dhe vuri

gishtin në këmbëz. Dervishi, duke u dridhur si purtekë, u shtri sa gjatë gjerë në tokë. Çallma i doli nga koka, u rrokullis tatëpjetë, në një rrëpirë dhe ra në një përrua të thellë. Komandanti, kur e pa dervishin në një gjendje të tillë, hodhi pushkën në sup dhe u drejtua nga luftëtarët:

— Ja, vëllezër! Ne derdhim gjakun për vatan, kurse ky horr me shokët e tij venë e mashtrojnë gratë dhe nënat tona e u marrin edhe kafshitën e gojës!

— Aman! — thërriste duke lebetitur dervishi.
— Për allanë, s'kam për të dalë më!

Komandanti dha urdhër që të kontrolloheshin thasët dhe torbat që kishte ngarkuar dervishi në kuajt. Vullnetarët gjetën përveç dy thasëve me miell të bardhë, edhe një kusi të madhe me mjaltë, dy qypa me gjalpë, një teneqe me vaj ulliri, një shportë me 50 kokrra vezë dhe një torbë me fasule. Kishte edhe nja tri vargje me duhan të zgjedhur. Këto i mbajtën vullnetarët për nevojat e tyre.

Dervish Zeneli, i cili dridhej sikur ta kishin zënë ethet e gushtit, u nis për në shtëpi, duke marrë kuajt për kapistre, pa «hakun» e nuskave dhe pa çallmë në kokë...!

Kjo ndodhi më 20 gusht të vitit 1920.

PAS KTHIMIT NGA LUFTA!

Në tetor të vitit 1920, Fejzo Gjylameti po kthehej në shtëpi. Ai kishte afër gjashtë muaj që nuk e kishte parë familjen me sy. Si pjesëmarrës vullnetar në Luftën e Vlorës kundër pushtuesve italianë, ai ishte plagosur në këmbën e djathtë, ishte shtruar në spital dhe kjo e bëri atë që të kthehej pranë gruas e fëmijëve që e pritnin me padurim gati dy muaj më vonë se vullnetarët e tjerë.

Me një pushkë të gjatë në sup, me një shkop në dorë dhe me gunën e dhirtë në krahë, ai u nis për rrugë në mëngjes herët. E mbas tetë orë udhëtimi rrugë e pa rrugë, më në fund arriti në fshatin e tij. Sa doli në vendin e quajtur «Gropa e derrit», ku fshati dukej i tëri, gati pothuaj shtangu në vend dhe ndenji për disa minuta më këmbë, pa luajtur fare nga vendi. As vetë nuk e kuptoi se si iu mbushën sytë me lotë.

«Fshati! — murmuriti ai me vete. — Sa i bukur që po më duket sot!» — Pastaj u ul mbi një gur e nuk po ngopej së shikuari. Shikonte shtëpitë e rralla të fshatit, arat, pemët, përrenjtë, lumin e vogël që kalonte anës fshatit dhe gjithçka që i dilte përpara. Herë pas here fshinte ndonjë pikë loti! Kishte bërë gjithë atë rrugë më këmbë dhe e ndien-

te veten tepër të lodhur, po ngaqë donte të ndodhej sa më parë pranë fëmijëve, gruas e fshatarëve të tij, u ngrit menjëherë. Ecte sikur e ndiqte dikush nga prapa. Bënte disa hapa të shpejtë, ndalonte pak, merrte frymë thellë dhe pastaj vazhdonte përsëri të ecte. Një erë e freskët ia lëmonte fytyrën e ashpër e të verdhë dyllë. Veshët i gjëmonin nga lodhja e madhe, trupi filloi t'i dridhej, por ai vazhdonte rrugën me sytë drejt fshatit.

I pari nga njerëzit e familjes e pa Suloja, djali i tij tetëvjeçar. E njohu gati një kilometër larg.

— Nënë, nënë! Po vjen babai! — thirri ai tërë gëzim.

— Babai!? — u çudit e ëma. — Pa shiko, mor djalë, mos nuk është ai, se babai do të lajmëronte të vinim ta merrnim kur të shërohej, — vazhdoi ajo.

— Babai... babai..., — thirri përsëri djali dhe u nis me vrap, duke kaluar me shpejtësi nëpër gjerdhet dhe muret e fshatit. Diku këmba iu përplas pas një guri, por ai as që e ndali vrapin. Dhe vetëm pas pak, duke marrë frymë me zor, u gjend pranë të atit.

— Baba! Baba!

— Bir i babait... bir i babait!...

Fejzoja u ndal, e mori të birin, e ngriti në krahe, e shtrëngoi fort dhe e puthi e e puthi disa herë me dashuri e mallëngjim të papërmbajtur. Edhe Suloja e puthi të atin dhe e rroku fort për qafe. Pastaj babë e bir, të shtrënguar fort pas njëri-tjetrit filluan të ecnin për në shtëpi.

— A jeni mirë, bir i babait? — pyeti Fejzoja.

— Mirë, baba, mirë! — u përgjigj djali. — Edhe nëna është mirë, edhe Dilja është mirë. — Ata s'ngos

peshin së shikuari e së puthuri njëri-tjetrin. Pasi bënë një copë rrugë, Fejzoja ndaloi pak dhe e shikoi të birin nga këmbët deri te koka. Djali ishte zbathur, me pantallona copë-copë dhe me një këmishë tërë arna. Një si lëmsh iu bë në grykë dhe pastaj iu drejtua të birit:

— Opinga s'paske fare, djali im.

— M'u shqyen, — tha djali. — Ato nuk vishen më tani!

— Mirë, bir i babait, se do të shesim ndonjë dhi e do të të blejë babai një palë opinga të reja...

— Nuk më mërdhivin këmbët, — tha i biri. — M'u mësuani tani!

— Jo, bir, jo, nuk të lë babai zbathur ty! Diçka do të bëjmë, — tha i ati.

Ata vazhdonin të ecnin krah për krah.

— Ti je plagosur shumë, baba, ë? — pyeti djali.

— Po, bir, u plagosa! — foli i ati. — Ja mu këtu në këmbën e djathtë!

— Unë qava shumë kur dëgjova se ti, baba, u plagose, — tha i biri.

— Gabim ke bërë, — ia priti Fejzoja. — Njerëzit në luftë edhe mund të vriten, të keqen babai, se armiqtë, or bir, nuk vijnë për të mirë!

— Po edhe ti, ama, dy breshkamëdhenj i qërove, — tha djali. — Fejzoja qeshi, pastaj iu drejtua të birit:

— Kush ju tha juve se i qërova dy breshkamëdhenj?

— E ka marrë vesh gjithë fshati, — u përgjigj djali. — Të gjithë thonë: «I lumtë atij Fejzos!» — Vetëm Dalan beut sikur nuk i vjen mirë. E di si i tha një ditë xha Asllanit? «Epo djem nënash janë

edhe ata italianët!» «Po pse nuk rrinë pranë nënave të tyre?», — i tha xha Asllani. Dalan beu uli kokën dhe iku pa dhënë asnjë përgjigje. Xha Asllani i thirri Dalan beut: «E ku vete, o bej, apo do t'u ndezësh ndonjë qiri atyre që vrau Fejzoja!» — Dhe që atë ditë, Dalan beu sa herë shikon xha Asllanin, ndërron rrugë!

— Eh, mor bir, Dalan beu është mik i italia-nëve, po s'ka ç'të bëjë tani, se u ngrit tërë populli më këmbë dhe i hodhi në det të mallëkuarit!

Ndërkaq ata ishin afruar fare pranë shtëpisë së tyre të vogël përdhese, e cila ndodhej e veçuar, larg nga shtëpitë e tjera, gati më të dalë të fshatit. Gati të gjitha shtëpitë e atij fshati ishin të veçuara dhe larg njëra-tjetrës. Fshati ishte i vogël, gati njëzet shtëpi, por ato ishin të shpërndara disa nën kodra e disa të tjera në majë të kodrave. Shtëpia e Fejzos ishte në ultësirën e një kodre të zhveshur që zbardhonte ngà gurë të vegjël gëlqerorë. Tani ata ishin në oborr. Me ta parë Fejzon, qeni lehu fort dhe u turr me të shpejtë drejt tij. Ai nuk e njohu të zotin, veç kur dëgjoji zërin e tij që tha:

— Eh, more Murro, edhe ti më paske harruar me gjashtë muaj?!

Qeni qëndroi në vend, e shikoi të zotin për disa çaste, pastaj duke tundur bishtin zuri e po fërkohej pas gjunjëve të tij, sikur do t'i uronte mirëseardhjen. Te pragu i shtëpisë kishte dalë vajza e vogël, Dilja. Ajo sa kishte mbushur dy vjeç e gjysmë. E shikoi të atin me vërejtje, pastaj duke qarë hyri me të shpejtë në shtëpi. Rrobat e grisura të të atit, mjekra e parruar kushedi prej sa ditësh, koha e largimit prej gjashtë muajsh, e bënë vajzën që të mos e njohte të atin.

— Dile, Dile e babait! — thirri Fejzoja, por ai nuk dëgjoi tjetër gjë vetëm të qarët e përvajshëm të vajzës.

— Babai, Dile, babai, — thirri Suloja, po vajza tanimë qante brenda në shtëpi. Pas pak, me vajzën në krahë, doli e shoqja. Ajo i dha dorën të shoqit e gëzuar. Edhe Fejzos i qeshi fytyra. Vajza qante, shtrëngohej në gjoksin e së ëmës dhe shikonte me frikë nga i ati. Pastaj, si hyri në shtëpi, Fejzoja nxori nga xhepi ca kokra sheqerka që ia kishin dhuruar në spital edhe ia zgjati së bijës, më shumë për ta marrë me të mirë, po megjithatë vajza nuk i afrohej të atit. Ajo e shikonte atë me frikë, vëngër.

— Babai, moj shpirti i nënës, babai, — i tha e ëma. — Si e harrove babanë kaq shpejt, ti? — vazhdoi ajo. Po vajza hidhte sytë nga i ati, e shikonte atë dhe pastaj fillonte të shtrëngohej pas qafës së të ëmës.

— S'më njeh akoma, vajza! — tha Fejzoja.

— E nga të të njohë, — ia preu e shoqja me zë të ulët. — Ti ke ndryshuar shumë në këto gjashtë muaj, — vazhdoi ajo.

— Epo lufta të ndryshon, moj grua, — tha ai. — Pastaj plaga, spitali, lodhja...

— Korba unë, këto kohët e fundit nuk munda të vija në spital të të shikoja! — tha e shoqja. — S'kisha me kë të lija fëmijët, pastaj atë grusht dhi që kemi, lopën...

— Mirë bërë që nuk erdhe, — ia priti Fejzoja. — Rrugë e largët, pastaj grua, helbete, s'kishe si të vije vetëm!

— Më tha im vëlla, Asimi, që, kur të shëro-

heshe, do të vinte ai të të merrte, po ti nuk na lajmërove fare!

— S'më pritej, — tha Fejzoja. — U mërzita shumë në spital! Pastaj edhe shërbimi në të ishte shumë i keq. As që pyetnin për ne të plagosurit. — Gruaja e shikoi me vërejtje të shoqin.

— Asnjë palë rroba s'të paskan dhënë, pa le të tjerat, — tha ajo.

— Na dhanë nga një qylaf të bardhë, — i tha ai si me të qeshur.

— Jazëk, jazëk, — foli gruaja. — Pastaj qysh të lanë të vije më këmbë? — pyeti ajo.

— Po spitali nuk ka kuaj, moj grua, — tha Fejzoja.

— E di se spitali nuk ka kuaj, — ia priti e shoqja disi e zemëruar, — po ata të qeverisë nuk kishin ndonjë kalë të të sillnin deri këtu?

— Të qeverisë? Pika atyre mu në majën e kokës! — tha Fejzoja. — Ku pyesin ata për ne fukarenjtë! Ata e kanë mendjen te grindjet! Po zihen si qentë për koskat: kush të marrë pozitë më të madhe!

— Jazëk u qoftë, edepsëzëve! — shfryu gruaja. — Në fshat thonë se ti luftove mirë!

— Të gjithë luftuan mirë, — tha Fejzoja. — Trima u treguan që të gjithë!

— Të dhemb plaga tani? — pyeti e shoqja.

— Doemos që më dhemb! — tha Fejzoja dhe çoi dorën e djathtë te plaga.

— Shumë? — pyeti ajo përsëri.

— Më dhimbe shumë, po tani më pak, — tha Fejzoja. — Atëherë nuk të llafosa se nuk desha të të shqetësoja. Kur u plagosa, më rrodhi shumë gjak! Shokët më mbajtën në krahë më shumë se

dy sahat derisa më çuan në spital. Plagën ma lidhë një grua nga Elbasani, që kishte ardhur vullnetare në luftë. Krasta ia thoshin llagapin, por emrin s'ia mësova dot! Ah, ç'hyzmet që na ka bërë ne të plagosurve! Motër e shkuar motrës!

— Kishte shumë gra në luftë? — pyeti e shoqja.

— Posi nuk kishte, — tha Fejzoja. — Dhe u treguan trimëresha njësoj si burrat!

— Ah, që nuk erdha dhe unë! — tha ajo.

— Ti kishe fëmijë e vegjël, — tha Fejzoja. Pastaj kë do të linim në shtëpi? Ne s'kemi njeri tjetër. Djalin e kemi të vogël, pastaj vajzën. — Gruaja uli kokën. Ai e shikoi të shoqen me një dashuri të veçantë. Iu duk tepër e dobët. Ai nuk e kishte lënë ashtu. Ajo kishte marrë një pamje me të vërtetë për të ardhur keq. Ishte zverdhur, dukej tepër e lodhur, me sy të futur thellë, sy të mekur. Ndoshta një pamje të tillë ia jepte edhe fustani i zi, tërë arna dhe shamia e vjetëruar që mbante në kokë.

— Ti si ke bërë hall këta gjashtë muaj? — pyeti Fejzoja.

— Si mos më keq, — u përgjigj ajo. — Herë me bukë e herë pa bukë. Fëmijë, siç i shikon, janë zbathur e zhveshur.

Fejzoja psherëtiu thellë. Uli kokën dhe ra në mendime. Edhe e shoqja uli kokën. Ata qëndruan ashtu për disa minuta.

— Mos u mërzit! Diçka do të bëjmë, — tha Fejzoja.

— Po le, po nuk na lë rehat as ai shpirtkazma, Dalan beu, — tha e shoqja.

— Pse, ç'ka me ne Dalan beu? — pyeti Fejzoja.

— Na kërkon borxhin, — tha e shoqja. — Qi-

ranë e tokës, pastaj paratë e atyre tridhjetë okëve misër që i kemi marrë vjet!

— Aha, kam harruar fare që i kam borxh Dailan heut! Ptui! Dreqi e marrtë këtë punë! Po ç'thotë? Kërkon borxhin? — pyeti Fejzoja.

— Ka ardhur disa herë, — u përgjigj gruaja.

— I poshtri! — shfryu Fejzoja. — Po ai e di që unë isha në luftë, e di që u plagosa...

— E ku pyet ai nga ato, mor burrë! Ju ishit në zjarrin e luftës, kur faqeziu erdhi e më tha: «Dëgjo, moj Fatime! Yt shoq mund të vritet në luftë, se nuk i dihet asaj, luftë i thonë! Po ti a e di atë punën e atij borxhit që më keni?» «E di, — i thashë, — po nga unë mos prit gjë, se unë mezi po ushqej fëmijtë e jo të paguaj edhe borxhin». — Dhe si e pa që nuk nxori gjë nga unë, atëherë nxori një letër nga xhepi dhe më tha: «Hë, vër gishtin këtu!» «Për se?» — i thashë. «Ja, që më ke dhjetë napolona borxh». «Unë nuk e di sa të ka im shoq.» — i thashë. Ai u xhindos dhe m'u kërcënua, por unë...

— Ai do dyfekun në kokë, — tha Fejzoja, — po ç't'i bësh kohës! Nejse! Lëre djallin, mos na e zë në gojë! — Pas një heshtje të shkurtër Fejzoja e pyeti të shoqen për ato pak kokë dhi që kishte, për lopën, për gomarin, për arat. Si mori përgjigje për të gjitha, ai u mbështet pas murit dhe hoqi ngadalë opingat, që gati i ishin ngjitur pas këmbëve.

— Sa shumë jam lodhur! — tha ai. — S'i thonë shaka, tetë sahat më këmbë. Pastaj, kjo e shkretë plagë akoma s'po më mbyllet!

— Të vë pak ujë të ngroutë e të futësh këmbët? — pyeti e shoqja.

— Edhe më pyet! — tha Fejzoja. — Shpejt, aman, të keqen, — vazhdoi ai.

Gruaja u ngrit, mbushi një kusi me ujë dhe e vuri në zjarr.

— Jemi keq edhe me dru, — foli ajo.

— Pse, si është puna?! — pyeti i habitur Fejzoja.

— S'na lë Dalan beu të presim në pyllin e dëllinjës, — tha ajo. — Duhet të shkojmë katër orë larg, në Dobrie...

— Aman, të kam rixha, mos ma zë në gojë atë qerrata Dalan bej, se po xhindosem! — tha Fejzoja.

— Epo me atë kemi të bëjmë, mor burrë. — Ai na ka në dorë!

— Do t'i vijë koha dhe atij, mos ki merak, — tha Fejzoja.

— Mos e thuaj atë fjalë, or burrë. E ç'i gjen bejlerët dhe agallarët? Ata kanë fuqi të na zhdukin fare nga faqja e dheut! Ata s'kanë frikë as nga hyqymeti, as edhe nga allahu! Se hyqymetin e kanë ata në dorë.

— Po do të vijë koha që ne t'i zhdukim ata me rrënjë e me degë, dëgjon?

— As që më besohet, or burrë...

— Dëgjo këtu, grua! Në luftë kam njohur një djalë nga Tërbaçi! Halim Xhelo ia thoshin emrin. Ishte edhe trim, edhe i ditur. Erdhi më pa disa herë në spital. Ai na tha se diku në një vend ishin ngritur të gjithë punëtorët dhe fshatarët e i kishin zhdukur bejlerët e të pasurit. Kështu duhet të ngrihemi edhe ne ndonjë ditë. Dhe patjetër që do të ngrihemi!

— Po ku bie ky vend, or burrë? — pyeti me zë të ulët. — Është larg nga ne?

Fejzoja qeshi.

— Nuk është fshat, moj grua, jo, është një shtet i madh... i madh...

— Uaa! Dhe i vranë të gjithë agallarët?

— Të gjithë, të gjithë të pasurit! — tha Fezoja.

— I qëruan me soj e sorollop!

— O perëndi, sikur ta bëjmë ne këtu siç bënë ata atje!

— Pa tjetër që do ta bëjmë, — tha Fezoja.

Ndërkaq ujët kishte zier. Gruaja e zbrazi atë në një legen dhe Fezoja vuri këmbët brenda. Po s'kaloi as pesë minuta, kur nga jashtë u dëgjua një zë i fortë:

— Aty je, moj nusja e Fezjos!

— O perëndi, Dalan beu! — tha ajo. Fezoja shtangu në vend. Përsëri u dëgjua zëri i Dalan beut:

— E, aty je, o, moj nusja e Fezjos?

— Dalan katili! — tha Fezoja. — Zëri i atij është! Po ku dreqin më paska parë! — vazhdoi ai.

— Zëri i atij qeni është, — tha gruaja. Po pa mbaruar mirë gruaja fjalët, në dhomë hyri Dalan beu. Kishte veshur çizme të verdha, të lustruara mirë, pantallona qillota, një xhaketë ngjyrë kafe dhe në kokë kishte vënë një feste të zezë prej kandidate, që thuhej se e kishte blerë në Stamboll, kur kishte qenë për të mësuar. Nuk ishte dhe shumë i shëndoshë, megjithëse hante nga një pulë në vaft. Vetullat i kishte të dendura dhe të ngritura përpjetë. Flokët sa kishin filluar t'i thinjeshin. Në dorën e majtë mbante një palë tespihe të verdha dyllë, kurse në dorën e djathtë mbante një kamxhik të shkurtër. Porsa hyri në dhomë dhe pa Fezjon që kishte futur këmbët në legen, gati shtangu në vend.

— Fezo! E, ti je, more lumëzi?! — tha ai, duke e shikuar me vërejtje.

— Unë jam, o Dalan bej, unë! — tha Fejzoja pa luajtur fare nga vendi.

— Shiko, shiko! Po mezi të njoha, o lumëzil Për Abaz Alinë sikur të të kisha parë në rrugë, nuk do të të kisha njohur! Demek erdhe, ë?

— Erdha, erdha! Siç më sheh, unë jam Fejzoja!

— Të shoh, të shoh, xhanëm! Po si je, mirë je? — pyeti Dalan beu.

— Mirë jam, — tha Fejzoja. — Mirë.

Dalan beu i hodhi sytë Fejzos dhe e shikoi me vërejtje nga këmbët e deri te koka.

— Ç'mirëzezë qenke, more Fejzo! Po ti qenke bërë për ibret, more i zi! Pupu! Si qenke bërë!

— Po ti, Dalan bej, mirë je? — pyeti Fejzoja, pa ua vënë veshin fjalëve të beut.

Dalan beu ngriti kokën dhe i hodhi një vështrim të rreptë Fejzos, pa nxjerrë asnjë fjalë nga goja. Ishte hera e parë në jetën e tij, që një «harbut», si i quante ai fshatarët, nuk i ngrihej më këmbë, dhe aq më tepër nuk i fliste me «zotrote», po me ti. Pastaj ngadalë, pa i hequr sytë nga Fejzoja, u ul mbi një sëndyq që ishte vendosur pranë qoshes së shtëpisë dhe që shërbente edhe për t'u ulur njerëzit. Edhe Fejzoja e pa me vërejtje Dalan beun. Pastaj beu duke tundur kamxhikun pas çizmeve tha me gjysmë zëri:

— Për mejtimin tim, or Fejzo lumëziu, bëre gabim që vajte vullnetar në luftë!

Fejzoja e shikoi ashpër beun dhe i tha me zërin e tij të trashë e të vendosur:

— Përse m'i thua këto fjalë, o bej?

— Se nuk mbeti Shqipëria për ty, de! Ti...

— Nuk po të kuptoj dot, — foli Fejzoja. — Kundon të dalësh me këto fjalë?

— Oj, s'më kuptoke! — tha Dalan beu. — Po pse, ore jahu, kaq i trashë qenke ti, de?!

— Jo, jo, s'po të kuptoj dot, — u përgjigj Fejzoja.

— Po ja, ore babaxhan, sikur të ishte vrrarë, do të të kishin mbetur fëmija rrugëve! Kush do të t'i mbante? Gruaja? Po ajo dy derhem shpirt ka! Shiko si është bërë, koskë e lëkurë! Ti je njeri me halle, o Fejzo, prandaj mejtoj që vajtja tënde në luftë ishte e panevojshme! Se, si thashë, ti je njeri me halle! Hallexhi hesapi!

— Halli im është halli i gjithë Shqipërisë, o Dalan bej, — tha Fejzoja. — Kur shkelet vatani nga të huajt, ai është halli më i madh për çdo njeri!

— E, ore, e, tregoi arat babait ti! Se nuk e di unë se ç'është vatani! M'i ka mësuar nëna që në djep mua këto që po m'i thua ti, dëgjon, apo jo? Po puna është se ti ishe i vetëm! Të shkonin ata që linin nga një njeri në shtëpi, demek nga një burrë dhe jo ti! Prandaj po ta them, jo se nuk duhet luftuar për Shqipërinë e nuk më dhimbset mua vatani! Se vatani, jahu, është i shenjtë! S'ka më i shenjtë se vatani, se për vatan janë vrrarë me mijëra, se për vatan...

— Ka edhe që bëjnë sehir, — ia priti Fejzoja.

— Mos e ke fjalën për mua? — pyeti Dalan beu.

— Për sehirxhinjtë, — shfryu Fejzoja duke i hedhur sytë drejt Dalan beut.

— Dëgjo, o Fejzo! Unë nuk jam mësuar t'i jap llogari asnjeriu për punët e mia, po meqenëse ti po më dogëndis, atëherë merr vesh se unë vuaj nga mullëza¹⁾, pa do të kisha shkuar i pari në luftë, dë-

1) Mëlçia e zezë.

gjove? Dëgjova thuaj! Se unë nuk jam fis frikacakësh, se gjyshi im ka qenë i dalluar në luftime kundër jemenasve, saqë vetë Sulltan Xheviti i ka dhënë nishanin¹⁾ më të lartë. Edhe sot e kësaj dite e ruajmë në shtëpi atë nishan si gjënë më të shtrenjtë, se tregon se kush është familja jonë, — vazhdoi ai duke folur me zë të lartë dhe pak i nxehur.

— Ruajeni fort atë nishan, — i tha serioz Fejzoja, — se ai nishan «nderon» fisin tuaj!

— Doemos që na nderon, — u përgjigj Dalan beu. — Ndryshe nuk e mbanim! Po t'i lëmë këto, o Fejzo, e na trego ndonjë gjë andej nga lufta!

— Ç'të them, o Dalan bej! Luftën tonë e mori vesh e gjithë bota!

— E, ashtu, ashtu është. — Ua bëtë mirë qirhanexhinjve! Epo e kërkonin, de!

— Aman, jarebi, si bërtitnin e si thërritnin kur i vumë përpara si bagëtinë! Sidomos kur i thyem në Qafën e Kociut, o Dalan bej, besoj se të thirrurat e të lebetiturat e tyre do t'i kenë dëgjuar edhe në Romë, për perëndi!

— Dhe ju bamb mbi ta, — tha Dalan beu duke shtrembëruar pak buzën e poshtme.

— Oj, bamp! Na u errën sytë, — tha Fejzoja. — Kërmë i bëmë të mallëkuarit! Epo ç'faj u kishim, o Dalan bej! U thamë të iknin me të mirë, kurse ai xheneral Paçentini u tall me ne, se nuk ia mbushnim syrin, se ishim të vegjël! Epo mirë, u thamë ne, paçi veten më qafë! Dhe u dhamë dërmën e i hodhëm në det!

— Më thanë se edhe ti, Fejzo, i vrave nja dy vetë! Është e vërtetë? — pyeti Dalan beu.

1) Medaljen.

— Shokët vranë më shumë se unë, o Dalan bej, — u përgjigj Fejzoja.

— Po ti, xhanëm, ti, i vrave dy atë ditë që u plagose, apo ashtu thonë? — pyeti Dalan beu.

— I vrava me gurë, se fishekët më qenë mbaruar. I kishim me këtë të flamosurit, megjithëse më vonë patëm, se zumë depot e armikut. Njëri prej tyre ishte toger. I gjetëm në xhep urdhrin e gradimit për kapiten, po nuk kishte proftasur t'i vinte gradat, i mallëkuari. Siç u mor vesh më vonë, ai kishte dhënë urdhër për djegien e shumë fshatra-ve në krahinën e Vlorës. Dysh ia ndava kokën me gurë, qenit!

Dalan beu u kollit fort, lëvizi pak nga vendi dhe me zë mbyhtës kërkoi një gotë ujë. Si piu ujë, iu drejtua Fejzos:

— More Fejzo, po për atë borxhin tim, a të ka shkuar ndër mend ndonjëherë?

— Për cilin borxh, bej?

— E, ore, për borxhin që më ke mua?

— Aha, për borxhin që të kam ty! Për besë, të të them të drejtën, nuk më ka shkuar ndër mend, o Dalan bej! E kam pasur mendjen të vritja sa më shumë armiq? Pastaj, siç e ke marrë vesh, u plagosa dhe kështu s'më ka shkuar ndër mend borxhi tënd.

— Shumë keq, o Fejzo, shumë keq! Ti e di që borxhi është borxh dhe ai duhet larë, të shkretën! Apo nuk e di një gjë të tillë?

— E di, si nuk e di, — tha Fejzoja.

— Epo kur e di, hë, de, ke nijet të m'i numërosh paratë në dorë? Hë, si thua?

— E ku t'i gjej, o Dalan bej?

— Aha, atë nuk e di unë se ku do t'i gjesh ti,

— tha Dalan beu me inat. — Sipas fjalës që kemi pasur, ti do të ma paguaje borxhin gjashtë-shtatë muaj më parë. Kështu? Apo mos gënjej unë?

— Po qëlloi që shkova në luftë, a Dalan bej.

— Borxhi është borxh dhe lufta është luftë. — tha Dalan beu. — Nuk ka dalë ndonjë ligj, efen-dëm, që të thotë se ata që kanë qenë në luftë nuk duhet të paguajnë borxhet! Apo mos vallë ka ndo-një ligj të tillë? Ë?

— Unë nuk di se ç'ligje dalin.

— Ja ta them unë se nuk ka ndonjë ligj të tillë! Prandaj ti, Fejzo Gjylameti, duhet të më paguash borxhin!

— Po ti e di, ore bej, se akoma s'm'u ka mby-llur plaga, e tani unë nuk kam. . .

— Po mirë, more i uruar, nuk i gjete ndonjë italiani të vrarë para në xhep? — pyeti Dalan beu.

Fejzoja hoqi këmbët nga legeni, damarët e ba-llit filluan t'i rrihnin me shpejtësi, fytyra i mori një pamje të egërsuar.

— Të të vijë turp, o Dalan bej, që nxjerr nga goja tënde fjalë të tilla! Turp!

Dalan beu luajti nga vendi, filloi të tundte kë- mbën e djathtë dhe e shikoi Fejzon me një egërsi të çuditshme.

— Pse m'i thua këto fjalë, o Fejzo? Çfarë tha- shë unë që më thua të kem turp?

— Se nuk vajtëm të plaçkitnim italianët, o Da- lan bej! Ata erdhën të na merrnin edhe pasurinë, edhe nderin! . . .

— Po ti mos merr inat, jahu, mos merr inat. -- tha Dalan beu. — Thashë se kushedi i gjete ndonjë të vrari para në xhep, se ata janë zengjinë dhe kur venë ushtarë marrin para me vete!

— Dëgjo bej, — tha Fejzoja, që tani filloj t'i dridhej edhe trupi. — Ti po më dogëndis thellë, po të kam rixha, vëri gojës fre! Ndryshe, dije se nuk ke për t'u ndarë mirë me mua!

— Mos, more! Koka tënde kërkon t'i vërë fre gojës sime! A je në vete ti, apo mos ke shkalluar? Po a e di, more dejus, se kush jam unë? Jam Dalan bej Kasimati, unë, që s'kam pyetur nga burra më të mirë se ti dhe jo nga një copë çoban që s'di nga lidhet gomari!

— Po ti pse më ul aq poshtë? — tha Fejzoja.
— Pse më bën plaçkaxhi. Sikur unë vajta në luftë të plaçkitja e jo të luftoja italianët për lirinë e vatani!

— Mbylle gojën, dejus! — gërthiti Dalan beu.
— Me sa kuptoj unë, ti, meqenëse vajte në luftë, kërkon që të të falen taksat, të mos të të marrim qiranë e tokës, të mos kërkojmë borxhet e ku ta di unë, ç'kërkon ti të tjera! Po jo, o Fejzo, jo, një gjë e tillë nuk do të ndodhë kurrë! Prandaj, hajde shpejt, më cakto ditën se kur do të ma lashë borxhin! Hajde shpejt, që tani! Më thuaj se kur do të ma japësh borxhin!

— Ditën nuk ta caktoj dot, — tha Fejzoja.

— Pa shiko, pa shiko ç'na qenka! Demek nuk më caktoke dot ditën, ë? Mos vallë pret të vijë bollshevizma edhe këtu?

— Unë nuk e di ç'është bollshevizma, Dalan bej, po nuk ta caktoj dot ditën e larjes së borxhit, se nuk kam!

— Ti gënjen, more dimsëz! Ti gënjen që nuk ke! — tha Dalan beu, duke iu mbushur buzët tërë

jargë nga inati. — Ke dhinë, ke lopën, ke arën, ke gomarin! Shiti dhe më paguaj mua borxhin!

— Ato nuk mund t'i shes, se me ato mbahem gjallë, — tha Fejzoja.

— Mua nuk më duhet se kush të mban gjallë ty, unë dua hesapin tim!

— Vër dorën në zemër, o bej, — tha gruaja e Fejzos, e cila deri atëherë vetëm kishte dëgjuar dhe nuk e kishte hapur fare gojën. — Mendo edhe për fëmijët tanë! — vazhdoi ajo.

— Me njerëz si Fejzo unë nuk mund të merrem vesh, — tha Dalan beu. — Ky qenka tërbuar fare që kur vajti në luftë!

— Po nga e keqja e ka, o bej, — tha gruaja. — S'është se kemi e nuk t'i dhamë!

— Edhe unë nga e keqja e kam, — tha Dalan beu.

— Ç'e keqe të zuri ty, o Dalan bej? — pyeti Fejzoja tërë inat.

— Hallet e shtëpisë sime i di unë vetë dhe jo ti. Shpenzimet më janë shtuar shumë, më vijnë miq nga anë e anës! Pastaj djali që kam në Evropë për të mësuar më kërkon pa tjetër njëzet napolona flori!

— Ja ç'na qenka, — tha Fejzoja. — Djali im nuk ka opinga në këmbë, as këmbë në trup, as bukë të mbushë barkun, kurse djali tënd kërkon para të bredhë me kurvat nëpër rrugët e qyteteve të Evropës.

— O allah i madh, ç'po më dëgjojnë veshët! — tha Dalan beu duke luajtur nga vendi. — Me sa kuptoj unë, ajo vajtja në luftë të paska mësuar ca hynere të poshtra! Po dëgjo, o Fejzo!

— Unë...

— More lëri llafet, se as kam kohë dhe as ka lezet që unë, Dalan bej Kasimati, të merrem me një harbut si ti, por po të pyes për të fundit herë: a do të ma caktosh ditën kur do të ma japësh borxhin?

— Jo, o bej, nuk ta caktoj dot, — tha Fejzoja. Dhe të kam rixha më lër në hallin tim, se jam shumë i lodhur! Sa erdha, dreqi ta marrë! Prit të ç'mallem me fëmijët!..

— E mora vesh! — tha Dalan beu duke u dridhur i tëri nga inati. — Po ta dish, unë qysh nesër do të dëngoja qehajallarët të të marrin bagëtinë, lopën dhe pa të shohim nëse lahet borxhi që më ke! — Ai u ngrit tërë inat, rrahu kamxhikun pas çizmeve dhe doli përjashta me tërsëllëm. Burrë e grua si të egërsuar shikuan njëri-tjetrin në sy për një copë herë.

— Po tani? — murmuriti Fejzoja. — Ç'do të bëjmë?

— Unë them t'i bëjmë edhe një herë rixha atij të mallëkuarit Dalan bej, se mos ishallah, i zbutet zemra, — tha e shoqja. — Nuk dihet...

— Jo, kurrën e kurrës! — tha i vendosur Fejzoja. — Unë nuk i bie ndër këmbë atij qeni të pangopur. Ç'ka në dorë, le ta bëjë!

— Epo më mirë të na marrë shpirtin, sesa bagëtinë dhe lopën, — tha e shoqja.

— Po, më mirë shpirtin, — tha Fejzoja dhe hodhi sytë nga pushka, të cilën e kishte varur në mur.



Të nesërmen Fejzoja u gdhi i sëmurë. Këmbën e plagosur gati nuk e luante fare. Ajo i ishte mpirë krejtësisht. Plaga kishte filluar t'i enjtej. E shoqja dukej tepër e mërzhitur.

— Nga lodhja e kam, — i tha ai së shpejtë. — Mos u bëj merak!

— Ke bërë gjithë atë rrugë më këmbë! Tani çlodhu disa ditë, kurse unë po çoj bagëtinë për t'i kullotur. Dhe do t'i çoj sa më larg, që të mos m'i gjejnë dot qehajallarët e beut, — vazhdoi ajo.

— Po sikur të vijnë e të t'i marrin atje, çfarë do të bësh vetëm? — pyeti Fejzoja.

— Atëherë do t'i vras me sëpatë, me gurë, ashtu si vrave ti italianët, — tha e shoqja. Fejzoja i buzëqeshi dhe tundi kokën në shenjë aprovimi.

Po qehajallarët e beut nuk erdhën as atë ditë, as të nesërmen dhe as të pasnesërmen. Vetëm ditën e katërt, në mëngjes, vonë, përpara shtëpisë së Fejzos erdhi vetë Dalan beu, hipur mbi një mushkë xanaxare.

— Dil pak në oborr, o Fejzo! — thirri beu pa zbritur nga mushka. Fejzoja mezi u ngrit. Këmba po i dhimbte për qamet.

«Erdhi djalli!» — murmuriti Fejzoja me vete. Trupi iu drodh i tëri. Mengadalë, duke hequr këmbën zvarrë, doli në dritare. Pa beun që rrinte i ngrehur në shalën e mushkës. Nuk i foli fare, vetëm hodhi sytë drejt tij.

— Shiko, o Fejzo, — tha Dalan beu, — unë nuk t'i dërgova qehajallarët, po kjo nuk do të thotë

se nuk do të t'i dërgoj! Të lashë kohë të mendohe-
she! Hë, si do të bësh? Je menduar?

— Përse të mendohem?

— Për borxhin, për se tjetër! — foli me inat
Dalan beu.

— Unë ta thashë fjalën time, o bej. Ti qenke
tuhaf njeri! Ç'është kjo punë me ty? Më lërë të
marr veten! Qenke me të vërtetë xhahil!

— Oh, oh, ç'po dëgjoj! — tha Dalan beu. —
Epo paç veten më qafë! — vazhdoi ai dhe me një
të shtrënguar të frerit e ktheu mushkën nga kishte
ardhur. — Veç dëgjo, o Fejzo, — thirri ai, pa kthy-
er kokën, — mos u sill pengesa qehajallarëve, se
ata kanë edhe urdhrin e hyqymetit për të marrë
bagëtinë tënde, more vesh, apo jo?

Mushka, si për çudi, zuri vend dhe nuk po
bënte këmbë tutje. Ndoshta vetë beu e mbante për
freri në mënyrë që t'i linte edhe pak kohë Fejzos
për t'u menduar. Mushka ngrihej mbi dy këmbët
e prapme, qëndronte ashtu për disa sekonda, pas-
taj qëndronte mbi këmbët e para dhe qëllonte me
shqelma. Dalan beu mbahej fort pas kaptellit të
shalës. Ai e qëllonte ndonjëherë lehtë mushkën ose
e shponte me yzengji, po kafsha inatosej edhe më
tepër e nuk luante nga vendi. Fejzoja me shpejtësi
të habitshme mori pushkën që ishte varur në mur.
Ai tani e harroi dhembjen e plagës. Nxori tytën e
saj në dritare dhe shënoi mirë në Dalan beun.

«Ti, qerhanexhi, — tha me vete Fejzoja, duke
shtrënguar dhëmbët, — kërkon të marrësh shpirtin
tim, të fëmijëve, të gruas sime! Po pse mos të ta
marr unë më parë ty? — Pastaj thirri me zë jo
shumë të lartë: — Merre borxhin, o Dalan bej!»

Një krismë pushke u dëgjua në atë anë të fshatit. Trupi i Dalan beut me kokën varur u mënjanua dhe ra përmbys mbi shalën e mushkës. Mushka, e trembur nga krisma e pushkës, mori rrugën me të shpejtë. Koka e Dalan beut me plumb pas zverku filloi të tundej në anën e majtë të shalës, po këmbët, të karfosura mirë në yzengji, nuk e linin trupin të binte në tokë. Mushka, me trupin e të zot mbi vete, bridhte si e tërbuar, mbi rrugë e në rrugë, shala filloi të mënjanohet shumë bashkë me trupin e beut. Koka e Dalan beut zinte gur më gur e shkurre më shkurre derisa më në fund u këput edhe palldrëmi i kafshës e trupi i beut, i gjakosur dhe i copëtuar si mos më keq, mbeti në mes të disa ferrave bashkë me shalën e mushkës.

Ndërkaq Fejzoja me tytën e pushkës nxjerrë në dritare priste të vinin njerëzit e beut. Numëroi fishekët, ishin plot dhjetë! «Në mos dhjetë, të paktën pesë do t'i shtrij përtokë para se të vdes», — tha Fejzoja me vete. Po nuk po vinte njeri. Vetëm pak para se të errej, ai pa të shoqen që kishte vënë përpara bagëtinë, vajzën në kurriz dhe djalin që mbante lopën lidhur me litar për brirësh. Djali mbeti pak prapa se po i jepte ujë lopës, ndërsa grua ja mbylli bagëtinë në katua dhe e alarmuar, por edhe e gëzuar hyri në dhomë:

— Burrë! Di gjë ti?

— Çfarë? — pyeti Fejzoja.

— Dalan beun e ka rrëzuar mushka dhe e ka bërë copë-copë e për ibret! Na e mori hakun perëndia! — tha ajo.

Fejzoja i hodhi sytë pushkës që e kishte mbështetur mbi gjunjë, pastaj pyeti të shoqen:

— Po tjetër ç'thuhet për vrasjen e Dalan beut?

— Thuhet se dikush paska dëgjuar krismën e një pushke, po këtë punë e sqaroi xha Mustafai. Ai paska shtënë mbi një derr të egër dhe e paska lënë të vrrarë. — Pastaj ajo i tha të shoqit e gëzuar: — Shpëtuam nga Dalan katili, o burrë! Ne jemi për të bërë davet!

— Ka të tjerë Dalanë, — tha Fejzoja. — Është i biri, të vëllezërit, bejlerët e tjerë, agallarët! Ehu, sa ka për të qëruar! Po shpresë kemi, — vazhdoi Fejzoja. Dhe i ra pushkës me dorë.

ZHGENJIMI

Më në fund iu bë mbarë edhe Vesel Adushit të vinte te miku i tij, Xhaferr agai në Tiranë. I tha gruas t'i arnonte pantallonat e leshta që i ishin grisur në disa vende. Ajo ia pastroi mirë e mirë, pastaj i bëri një palë opinga me lëkurë lope, ndërsa Veseli u rrua, pastroi edhe festen e tij, u vesh me të vetmet rroba që kishte, i hipi kalit dhe u nis për rrugë të gjatë.

— E për ku kështu, o Vesel? — e pyetnin fshatarët që takonte rrugës.

— Te miku në Tiranë, — përgjigjej rëndë-rëndë Veseli. Dhe pastaj shtonte me mburrje: — Po shkoj andej nga Xhaferr agai, demëk nga vëllami. Do ta uroj se është bërë kolonel i xhandar-mërisë, de!

— Hej, si lum ti, o Vesel! — i thoshin fshatarët.

— Me siguri ndonjë koqe kapteri ka për të të bërë — i tha një fshatar.

— Epo nuk është ndonjë gjë e madhe, — përgjigjej Veseli. — I kam shpëtuar jetën, de!

— Kësaj i thonë të lindësh me fat, — i thoshin fshatarët dhe e uronin të kthehej shëndoshë me gradat e kapterit në gushë.

Mbas një udhëtimi të lodhshëm prej tri ditësh

dhe tri netësh, duke fjetur herë në një fshat dhe herë në një tjetër, më në fund Vesel Adushi mbërriti shëndoshë e mirë në Tiranë. Dhe nuk e pati vështirë për ta gjetur shtëpinë e Xhaferr agait. I pari qytetar që takoi dhe e pyeti për shtëpinë e mi-
kut, iu përgjigj:

— E kush nuk e di shtëpinë e zotit Xhaferr!
— Dhe e çoi përpara portës së tij. Po Veseli, para se të ndahej me qytetarin, nxori kutinë e duhanit dhe ia dha atij që të dridhte një cigare. Qytetari, pasi drodhi cigaren, e pyeti:

— Ku e njeh zotrote zotin Xhaferr, apo e ke gjë?

— E kam vëllamë, — tha Veseli duke u krekosur.

— Vërtet?! — u çudit qytetari.

— E përse çuditësh, mor mik? — tha Veseli.
— Vërtet gjak nuk kemi pirë, po do ta pimë edhe gjakun! Që ta marrësh vesh zotrote... si të quajnë?

— Rexhep.

— E gëzofsh, zoti Rexhep! E që ta marrësh vesh ti, zoti Rexhep, një vit më parë, në Luftën e Vlorës, unë isha vullnetar në çetat kundër Italisë, si gjithë fshatarësia e Vlorës, de! Një ditë komanda më çoi me shërbim në fshatin Armen. Kur arrita mbi urën e Shashicës, pashë dy italianë që po kërcënonin një civil. Civili lutej e qante, po njëri bile e qëlloi edhe me shqelm, kurse tjetri i kishte vënë koburen te koka. Mua nuk m'u durua më, u shtriva pas trungut të një ulliri, mora shenjë në drejtim të italianëve dhe thirra me sa fuqi kisha:

— Duart lart! — Me të dëgjuar zërin tim të vrazhdë italianët bërtitën «mama mia» — dhe ia

krisën vrapit tatëpjetë një përroi. Civili u shtri sa gjatë gjerë në tokë. U afrova dhe e pyeta:

— Kush je ti? Ç'bën këtu? — Ai u ngrit në këmbë dhe dridhej si purtekë, i shkreti. Pastaj mezi filloi të fliste:

— Jam Xhaferr agai nga Sulova! Më zunë këta qafira, kur po shkoja në çiflik dhe më kërkuan para, po unë s'kisha me yete. Më kërcënuan se do të më vritnin. Ah, i ziu unë! Po të mos ishe ti, unë sot do të kisha mbaruar! — Dhe pastaj m'u hodh në qafë e më tha: Ty të kam vëllamë në këtë jetë dhe në atë jetë! Dhe që atëherë ai më quajti vëllamë. Më do me kokë, për allanë. Më porositi t'i shkoja pa tjetër në shtëpi, se ndryshe do të zemërohej. Mirëpo ku na lënë punët ne fshatarët, o zoti Rexhep: ikin të mbjellat, vijnë të korrat, ikin të korrat vijnë të vjelat, ikin të vjelat, vijnë të mbjellat e kështu me radhë. Po tani vendosa të vij, sikur gameti të bëhet, sikur pa një kafshitë bukë të mbetem! E di që do të më jetë zemëruar Xhaferr agai që nuk kam ardhur më parë, po do ta rregulloj punën me të! Do të pranoj gabimin!

— Është bërë i madh Xhaferr agai, — tha qytetari. — E ke marrë vesh?

— Dre! Po si nuk e kam marrë vesh, jahu! Pse, kujton zotrote, se ne fshatarët nuk i marrim vesh ato që ndodhin këtu në Tiranë? I marrim, ore, i marrim, për allanë, menjëherë bile! Zàti edhe unë për atë kam ardhur më shumë, demek për ta uruar që ka marrë gradë të lartë e të madhe!

— Sa ditë do të rrish te zoti Xhaferr? — pyeti qytetari.

— Po kam nijet të rri nja pesë ditë, megjithëse

e di që nuk ka për të më lënë, po nuk rri dot më shumë, se kam shtëpinë vetëm!

— Kur e paske kaq mik zotin Xhaferr, do të të bëj një rixha... kam një hall.

— Urdhëro e fol, jahu! — tha Veseli.

— Unë... E di si është puna, më mirë s'po ta them sot. Nesër ti me siguri do të dalësh në pazar!

— Si jo, or jahu!

— Atëherë të pres te kafja e Rremës, në pazarin e vjetër! Pyet ku është kafja e Rremës, se të gjithë e dinë! Pimë dhe nga një kafe të mirë!

— Peqe, jahu, si të kesh qejf zotrote, — tha Veseli. — Nesër te kafja e Rremës!

— Si urdhëron! — tha qytetari. — Atëherë bëfsh natën e mirë!

— Edhe ti, jahu, e bëfsh natën e mirë! — tha Veseli. Qytetari iku dhe Veseli hodhi bishtin e cigares në tokë, pastaj u kthye nga shtëpia e Xhaferr agait. Shikoi me zili drejt asaj vile të bukur ku jetonte «miku» i tij. «Eh, more Xhaferr aga, se ku jetoke në këto saraje! A e mban mend kur të zunë ata breshkamëdhenjtë dhe unë të shpëtova prej tyre? Po qenke në xhenet, or t'u mbylltë! Po për mua a të ka rënë ndonjëherë në mendje, or vëllami im i dashur? A e di ti se ku jetoj unë, a e di si jeton vëllami tënd, o Xhaferr aga? Në një kasolle me drurë prej koçimare!» — Pastaj vuri dorën në ballë si strehë kapeleje dhe thirri me zë të lartë:

— O Xhaferr aga! Xhaferr aga, ore! — Dhe në këtë çast mendoj me vete: «Ah, sikur të më shikojë nga penxherja! Vallahi, që andej ka për t'u hedhur nga gëzimi që do të ndiejë për mua! Po sikur të më ketë harruar? Bah, çfarë them unë budallai! Ai sa nuk qau kur u ndamë bashkë! Apo i harroj unë

fjalët që më tha kur u ndamë: «Të më vish në shtëpi, se do të të pres si vëllanë tim, bile shkua vëllait. Do të të zemërohem po nuk më erdhe!» — Nderkaq ai bëri disa hapa më tej, duke iu afruar fare pranë shtëpisë së Xhaferr agait. Përsëri vuri dorën si strehë kapeleje në ballë dhe shikoi nga dritaret e shtëpisë së «mikut» të tij. Ndenji një copë herë ashtu mos shikonte njeri, pastaj thirri edhe një herë tjetër me zë të lartë:

— O Xhaferr aga! «More. — tha me vete, — mos është gabim që thërres kështu? Unë po thërres si në fshat, po këtu është qytet dhe nuk thirret me zë, po trokitet në portë. Ptu! Ç'bëra unë budallai!» — Pastaj iu afrua kalit, e mori prej kapistre dhe e lidhi pas një peme. U kthye dhe trokiti në portë, në fillim mengadalë pastaj më fort. Pas pak, portën e hapi një grua e bukur, ezmere, me ca sy të zinj si kokrra ulliri dhe me vëthë të mëdhenj në veshët e saj të vegjël. Sa hapi portën, Veseli i buzëqeshi dhe sa nuk iu hodh në qafë:

— Uaa! Qyqja! — thirri gruaja e frikësuar.

— Jam Veseli, Veseli... — Gruaja bëri disa hapa prapa dhe zgjati krahët e saj të gjatë për të mbullur portën.

— Mos u trembni, zonjë, mos u trembni, se unë jam Veseli! Nuk të ka thënë gjë Xhaferr agai...

— Ptu! — pështyu gruaja. — Më ngrive gjakun, or katundar i dreqit!

— Kot u trembe, zonjë! Kot...

— E di ti se kjo është shtëpia e kolonel Xhaferr beut, or të marroftë perëndia! Ore kungull i papjekur!

— Zonjë, mba gojën! Po ju keni të drejtë, se nuk më njihni, por i thoni Xhaferr agait se ka ar-

dhur Veseli! Atëherë do ta marrësh vesh mirë se kush jam unë!

— Ku e njeh ti Xhaferr beun, që e kërkoke me kaq axhele e kaq pa teklif sikur ta ka pjellë jot ëmë?

— Zotrote je gruaja e tij? — pyeti Veseli.

— Jam e motra, or matuf, jo gruaja!

— Aha! E motra! Po nuk ngjake hiç me Xhaferr aganë, moj më paç uratën! Ai është i bardhë, kurse zotrote qenke ezmere...

— Të pëlqej ndonjë çikë? Si thua? — Veseli u skuq në fytyrë, uli kokën dhe murmuriti ngadalë:

— Unë ty të kam motër!

— Uuu! — shtrembëroi buzët gruaja ezmere. — Dhe kush thotë se më paska motër mua! Edhe ky morracak! Po unë nuk të marr as për shërbëtor, ore qyq, jo të të kem vëlla! U, mos o zot, të të kem vëlla!

Dhe sikur të mos e dinte se ç'kërkonte Veseli, iu drejtua serioze: — Hajde, më thuaj se çfarë kërkon, se nuk kam kohë të merrem me një copë ka-tundar!

— Po Xhaferr aganë dua, moj më paç uratën, Xhaferr aganë, — tha Veseli, duke e përmbajtur vetën nga gjithë ato që i tha gruaja ezmere.

— Xhaferr beun thuaj, jo Xhaferr aganë, — tha gruaja.

— Aga ishte, bëj qenka bërë, — tha Veseli.

— Edhe pasha do të bëhet, — tha gruaja, — po beu, që ta marrësh vesh ti, zotrote, nuk pret një-rëz në shtëpi. Nesër shko në zyrën e tij, që e ka bash në mes të qytetit! Bile edhe nesër duhet të bësh një arzuallë, t'i vësh dy pulla përmbropa e pas-

taj të shohim a do të ketë kohë të të presë! Se ka shumë punë beu, or katundar i pagdhendur!

— Moj mba gojën! — tha Veseli, i cili tani mezi po e përmbante veten nga sharjet që po i bënte kjo grua e paedukatë. — Se, vallahi, bilahi, do t'i them Xhaferr agait që të të japë një dru që ta mbash mend për gjithë jetën! Se për mua. Xhaferr agai...

— Hahaha! — qeshi gruaja. — Dhe për kë të më japë mua dru Xhaferr beu! Për ty, more! — Na, të plaçin sytë e ballit!

— Moj nuk kam kohë të merrem me llafe, po shko i thuaj ç'të thashë! — tha Veseli. — Hajde shpejt se kam bërë tërë atë rrugë të gjatë dhe dua të çlodhem pak. — Gruaja mbylli derën me forcë dhe u fut brenda. Veseli mendoi me vete: «Ptu! E marrtë dreqi, e marrtë! Më mori erzim qafirja! Po nuk ka faj, se s'di e shkreta, që i kam shpëtuar jetën Xhaferr agait!» — Pastaj iu afrua kalit, hoqi nga samari një torbë, në të cilën kishte vënë një dy-tre kg. arra, ca mollë dhe fiq të thatë për Xhaferr aganë! E hodhi torbën në krahë dhe po priste te dera. «Me siguri, — tha me vete, — do të dalë Xhaferr agai të më presë!» — Në këtë çast dera u hap përgjysmë dhe gruaja ezmere zgjati kokën e tha:

— Xhaferr beut nuk i kujtohet ndonjë Vasil!

— Po jo Vasil, moj, më paç uratën, jo Vasil, po Vesel, Vesel Adushi! Vëllami, i thuaj! Veseli nga Kurveleshi! Ai që të shpëtoi jetën! Nga e gjete ti këtë Vasil?

Gruaja mbylli portën me forcë dhe hyri brenda.

«Ptu! — tha me vete Veseli. — Ma ktheu emrin nga Vesel në Vasil! Pa ia trgoj unë asaj shtrige! Po nuk i thashë Xhaferr agait që më mori er-

zin, mos më thëncin Vesel Adushi!» — Dhe, pasi u mëndua pak tha përsëri me vete: «Hë mo, dreqin, lëre! Se mos e dinte ajo se kush jam unë! Kur ta marrë vesh se cili jam unë, ajo sigurisht do të më kërktojë falje! Për këtë unë jam i sigurt!»

Priti më shumë se dhjetë minuta me torbë në krahë. Pastaj foli me vete, me zë të lartë: «More, nuk di se ç'po ndodh kështu! Mos nuk i ka thënë ajo shtrigë fare? Nuk është e mundur që të mos dilte vetë Xhaferr beu te porta e të më priste! Ai më bëri vëllamë!» — dhe trokiti përsëri në portë, po këtë radhë më fort. S'kaluan as dy minuta e dera u hap përgjysmë. Po tani nuk ishte më ajo gruaja e bukur, ezmere, po një burrë shtatlartë, pak i moshuar, me një hundë të madhe sa një patëllxhan. Ai nxori kokën dhe me një zë të hollë, si të ndonjë gruaje, tha:

— Ju, zotëri, e kërkuat Xhaferr beun?

— Unë, more mik, unë! — tha Veseli. — Kam një sahat që po pres te dera! Kam ardhur që nga anë e anës! Tri ditë rrugë kam bërë, dreqi ta marrë! — Dhe bëri të futej brenda. Po burri me hundë të madhe e ndaloi atë, duke nxjerrë përpara dy krahët e tij të gjatë, për hata:

— Ku doni të shkoni kështu?

— Te Xhaferr beu, jahu, — tha Veseli. — A nuk është kjo shtëpia e Xhaferr beut? Tani sa bisedova me të motrën dhe më tha se kjo është shtëpia e tij!

— Po, xhanëm, po, kjo është shtëpia e Xhaferr beut, po beut i vjem shumë keq që nuk mund t'ju presë dot as sot, as nesër, as për dhjetë ditë, sepse shkëlqesia e tij është i zënë shumë me punë tepër të rëndësishme. Dhe më besoni, zotëri, se atij po

i vjen mendja vërdallë! I vjen shumë keq, beut, besomë mua, zotëri!

Veselit iu rrëqeth i gjithë trupi.

— A e mori vesh që jam unë, Veseli? — pyeti ai i zverdhur në fytyrë.

— Posi jo, zotëri! Po sikurse ju thashë, Xhaferr beut po i vjen festja vërdallë! — Veseli turfulloi nga inati:

— Kjo është poshtërsi!

Burri shtatlartë dhe me hundën e madhe e mbylli derën me forcë. Veseli mbeti i habitur se si ia punoi «vëllami» i tij, ai, të cilit i kishte shpëtuar jetën! Dridhej nga inati.

«Ptu! — pështyu ai. — Farë e mallëkuar! E kush ka parë hajr nga agallarët, që të shikoj unë!» — Pastaj hodhi sytë nga dritaret e beut dhe, duke i rënë kraharorit, thirri tërë nervozizëm: «Ah, që nuk të lashë të të qëronin ata breshkamanët! Të paktën s'do të isha munduar deri këtu!»

Hodhi sytë rreth e rrotull. Errësira kishte mbuluar qytetin. Nga çdo anë errësirë.

«Po tani? — mendoi me vete, — ç'të bëj? Ku të mbytem?»

Syri i zuri një shtëpi të rrëzuar, nja treqind metra larg shtëpisë së Xhaferr agait. Aty, në një cep të asaj shtëpie, nxori eshkën dhe urorin e bëri një zjarr me disa shkarpa që gjeti andej-këndeje. Pastaj nxori bukën që i kishte mbetur në torbë, arrat, fiqtë dhe mollët që kishte sjellë për Xhaferr beun dhe u ngop mirë e mirë, sa desh plasi. Herë pas here shikonte nga dritaret e Xhaferr beut dhe pështynte me neveri. Edhe kali u kënaq, duke ngrënë në bar në atë livadh. I vuri kurrizin murit dhe

menjëherë e zuri një gjumë i thellë. Dhe vetëm pas disa orësh, të lehurat e qenve që vinin rrotull rreth kalit e trembën Veselin i cili u hodh përjetë.

«Bobo! — tha ai.» — Do të më kenë vjedhur kalin!

U ngrit menjëherë, shkoi te kali, i cili as që donte t'ia dinte nga të lehurat e qenve, por i ngopur mirë treste barin që kishte hedhur në bark! Ndërkaq filluan edhe këndesat të lajmëronin agimin e ditës së re, megjithëse ishte errësirë. Qëlloi qentë me gurë dhe pastaj i hipi kalit e u nis me të shpejtë. Nuk donte ta zinte dita në Tiranë. Ai u bind se në atë qytet kishte edhe njerëz të tjerë të ligj dhe të poshtër si Xhaferr beu...

«Ptu! Ptu! — pështyu ai disa herë në drejtim të dritares së Xhafer beut. — Me turp qofsh për jetë, o Xhaferr bej! — Kali nisi vrapin. Patkonjtë e tij nxirrnin shkëndija, duke u përpjekur pas gurëve të kalldrëmeve të Tiranës.

F u n d

PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
Kodra e të gjashtëve	3
Briganti	11
Bualli	24
Ndodhi pas një sulmi	29
Nëna e Mystehakut	35
Nuska e dervish Zenelit	44
Pas kthimit nga lufta	50
Zhënjimi	71